

RAPORTI VJETOR 2023



PËRMBAJTJA

LETËR NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE E ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET	1
RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET	2
RRETH RAPORTIT VJETOR 2023 TË ARTPOLIS	3
EDICIONI I 11-TË I FESTIVALIT FEMART	4
PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR FEMART 11	6
MEDIAT PËR FEMART 11	8
SHFAQJET PROFESIONALE	9
TOP GIRLS	10
TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR	11
SOBER	12
FEFU DHE SHOQET E SAJ	13
GRATË TROJANE – REPLIKA	14
TRE 1 T'ETI (T'THYMË)	15
FONDI PËR ART FEMINIST	16
KONCERT SOLISTIK NGA SOPRANOJA URTA HAZIRAJ	17
VLORA ADEMI SJELL LIBRIN “KATËRDHETË E PAK”	18
“UNË DHE UNË” NGA FLAKA LATIFI, NJË RRËFIM NJERËZOR PËR QËNDRUESHMËRINË	19
AGNES NOKSHIQI SJELL PERFORMANCËN “IN BETWEEN”	20
LEXIMI SKENIK “REDLIGHT ON SUNDAY”	21
“BREAK/ING”, NJË AKT I DASHURISË PËR VETEN	22
“JEPI NGJYRA JETËS”, ME RRËFIME PERSONALE PËR FUGIZIM TË GRAVE	23
MURALI KUNDËR DHUNËS DHE VRASJES SË GRAVE	24
“EDI: LABIRINTI DARDAN DHE PORTA E TUKANËS”, HOMAZH PËR EDI SHUKRIUN	25
“BE AWARE: PATRIARCHY DESTROY ZONE”, GODET FEMICIDIN DHE FTON GRATË NË SOLIDARITET	26
ARTIVIZMI FEMINIST	27
POEZI PËR FUQI – ÇDO DITË ËSHTË 8 MARS	28
MARSHOJMË S'FESTOJMË	29
PROTESTA “SHTETI FAJTOR PËR VRASJEN E SEBAHATE MORINËS”	30
#BOLL MA! STOP FEMICIDIT & HOPE BUBBLE	31
V, ZË I NDRYSHIMIT QË FRYMËZON FEMINISTET	32
PUBLIKIMI I RAPORTIT HULUMTUES RRETH NGACMIMEVE SEKSUALE NË UP	34
SESIONET INFORMUESE PËR RREGULLOREN NË UP	35
NATA E FILMIT NË ARTPOLIS NXIT DISKUTIM MBI NGACMIMET SEKSUALE	36
16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE	37
AKTIVIZMI FEMINIST NË NDËRTIMIN E PAQES	38
SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE	39
“GRATË TROJANE – REPLIKA”, NË UDHËTIM TË TRAGJEDISË NJERËZORE ME THIRRJE PËR PAQE	40
PUNËTORIA “LOJA TEATRORE SI NJË METODË PËR TË ANALIZUAR SHOQËRINË”	41
THYERJA E BARRIERAVE NDËRKULTURORE	42
KOLONIA ARTISTIKE NË BEOGRAD	43
“KALEIDOSCOPE” NDËRLIDHË RRËFIME PËRTEJ KUFIJVE	44
FEMART PËR PAQE	45
“KALLE TUTËN: NJË KONFERENCË PËR JETESË TË GUXIMSHME”	46
SHFAQJA TEATRORE “VAJZAT”	47
ALUMNI NETWORK	48
PROJEKTI TRANSNACIONAL UNMASC!	49

FUQIZIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE	50
ÇIKAT E SJELLSHME	51
EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN	52
KLUBET TEATRORE DHE TRAJNIMI EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR	53
SHFAQJET FORUM TEATËR DHE PERFORMANCAT	54
“PA LIMIT”, PËR KREATIVITETIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	55
TË RINJTË/REJAT E OBILIQIT ME SHFAQJE KUNDËR DHUNËS	56
SHFAQJA “HAMLET / HIGH – M’LE T / HI! – M’LE TË...” ME THIRRJE KUNDËR DHUNËS	57
“GJITHÇKA”, PËR NORMAT E MBIVENDOSURA PËR NËNAT VETUSHQYESE	58
“TECH-NO” ME MESAZHE RRETH NDIKIMEVE NEGATIVE TË TEKNOLOGJISË	59
“TRISOMY LOVE”, PËR DASHURINË DHE FUQIZIMIN I PERSONAVE ME DOWN SYNDROME	60
FUQIZIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	62
MES EMOCIONESH “BIBA MAY – JO MË” INSPIRON PËR JETËN	63
QASJA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR	64
TEATRI SI MJET PËR FUQIZIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR	65
RRITJA DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTPOLIS	66
PUNËTORIA “NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT DHE ANSAMBLIT TË ARTPOLIS”	67
STAFI DHE ANSAMBLI I ARTPOLIS VLERËSOJNË FEMART 11	68
PUNËTORIA “FUQIZIMI I ORGANIZATËS: NAVIGIMI I MBINGARKESËS SË PUNËS DHE NXITJA E MIRËQENIES”	69
FUQIZIMI I STAFIT	70
KUVENDI I PARË I ANËTARËSISË SË ARTPOLIS	71
VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET	72
STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË VENECIAS VIZITUAN ARTPOLIS	73
STUDENTË NGA MITROVICA DHE MITROVICA VERIORE VIZITUAN ARTPOLIS	74
KFOR-I ITALIAN VIZITON QENDRËN ARTPOLIS	75
DELEGACIONI NGA TEATRI ONDA VIZITON ARTPOLISIN	76
ZYRTARË TË PEACEBUILDING FUND VIZITOJNË ARTPOLISIN	77
STUDENTË NGA AMSTERDAMI VIZITOJNË ARTPOLISIN	78
PËRFAQËSUESËT E CFD-SË VIZITOJNË ARTPOLISIN	78
KONFERENCA “TEATRI SI MJET PËR NDRYSHIM NË SHOQËRI” NË PRIZREN FEST	79
BLLOGJET	80
VLERËSIMI DHE MONITORIMI	81
SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA	81
STATISTIKAT E VITIT 2023	82
STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE	84
MONITORIMI I MEDIAVE	85
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	86
TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT	87
STAFI I QENDRËS PËR ART DHE KOMUNITET - ARTPOLIS, 2023	88
ANSAMBLI I ARTPOLIS 2023	89
BORDI I ARTPOLIS 2023	90
DONATORËT E ARTPOLIS	91
RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART	92

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet

Adresa: Mujo Ulqinaku Rr, 8/8 (Pejton)

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 38 221 512

E-mail: ojq.artpolis@gmail.com

Facebook: <https://www.facebook.com/artpolisKosovo/>

Instagram: <https://www.instagram.com/artpoliscenter/>

Vimeo: <https://vimeo.com/artpoliscenter>

LETËR NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE E ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET



Foto: Esad Duraki

Zana Hoxha

Teksa reflektojmë mbi sfidat dhe qëndrueshmërinë kolektive në vitin 2023, me shumë mirënjohje dhe krenari ju prezantojmë Raportin Vjetor të Artpolis.

Në mesin e shumë pasigurive, luftërave e vështirësive, komuniteti ynë qëndroi i bashkuar dhe me vendosmëri, duke demonstruar edhe njëherë mbështetjen e palëkundur ndaj artit dhe aktivizmit tonë të përbashkët feminist për një të nesërme më të mirë. Jemi mirënjohës ndaj secilës/it prej jush që ka qenë pjesë e këtij rrugëtimi më 2023.

Falë përpjekjes së palëkundur kolektive ia kemi dalur të krijojmë, inspirojmë e fuqizojmë gra, të rinj e të reja, persona me aftësi të kufizuar e grupe të tjera të marginalizuara. Me përkushtim e të përbashkuara kemi realizuar 136 aktivitete, 6 shfaqje të reja profesionale, si dhe edicionin e 11-të të Festivalit FemArt që ka sjellë mbi 300 artiste/ë dhe aktiviste/ë nga

16 vende të botës. Kjo pjesëmarrje, jo vetëm që ka pasuruar programet tona, por ka qenë katalizator i ndryshimeve pozitive shoqërore.

Teksa shfletojmë faqet e këtij raporti, le të festojmë momentet e bukura që kemi përjetuar së bashku dhe të njohim ndikimin e thellë të kësaj përpjekje kolektive. Le të shërbejë ky dokument si një testament për fuqinë e komunitetit dhe potencialin transformues të artit dhe aktivizmit feminist.

Faleminderit për përkushtimin dhe besimin tuaj të palëkundur në misionin tonë. Së bashku, le të vazhdojmë të

REZISTOJMË!, INSPIROJMË! dhe **KRIJOJMË!** për të bërë ndryshime pozitive në botë.

RRETH ARTPOLIS - QENDRA PËR ART DHE KOMUNITET

Artpolis është organizatë joqeveritare që përmes kulturës, artit, edukimit dhe dialogut social ndikon në komunikimin dhe transformimin pozitiv të bashkëjetesës në komunitet.

E themeluar më 2004, vizioni i Artpolis është të krijojë një shoqëri të bazuar në vlera feministe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Misioni i Artpolis është të ndërtojë fuqinë kulturore të grave dhe të rinjve për t'u bërë inspirimi dhe ndikimi i shoqërisë për ndryshim. Vlerat e Artpolis janë: feminizmi, barazia gjinore, drejtësia, paqja, edukimi, fuqizimi, emancipimi, humanizmi dhe besnikëria.

Artpolis identifikohet lehtë si një ndër organizatat unike, e cila e përdorë teatrin dhe format e tjera artistike për të afirmuar, avokuar, edukuar dhe promovuar të drejtat e grave, të drejtat e njeriut, të drejtat e grupeve të margjinalizuara, barazinë gjinore, komunikimin me komunitetet multietnike, ndërtimin e paqes, fuqizimin e grave dhe të rinjve e të rejave. Ky aktivizëm artistik e bën të veçantë organizatën Artpolis, më afër qytetarëve, dhe ndërton relacione të sinqerta e më të fuqishme në komunikimin e përbashkët me komunitetin, duke gjetur përkrahjen e tyre. Ajo çka e dallon Artpolis-in nga organizatat e tjera joqeveritare është bashkëpunimi kreativ dhe edukativ me të rinjtë/rejat në nivel të lartë, përkrahja e komuniteteve pakicë, gjithëpërfshirja, diversiteti i grave në pushtet, ngritja e zërit kundër dhunës, pjesëmarrja aktive dhe masive e përkrahur nga komuniteti.

Disa nga aktivitetet kryesore të Artpolis janë: shfaqje profesionale teatrore, lexime skenike, trajnime, punëtori, konferenca, publikime, panele diskutimesh, ligjërata dhe diskutime publike, shfaqje filmash, koncerte, vallëzime bashkëkohore, protesta, marshe, fushata, performanca, pjesëmarrje në festivale teatrore jashtë vendit, aktivitete në rrugë me të rinj/reja, ekspozita, murale dhe instalacione, mbrëmje poezish, mbrëmje letrare dhe promovim librash, shfaqje forum teatër, mbrëmje përkujtimore të artisteve/ëve, joga dhe meditime, podkaste, intervista mediale, bashkëpunim me mediat dhe gru-

pet artistike ndërkombëtare, ndërtimi i relacionit me aktivistë ndërkombëtarë, edukim feminist, edukim teatror, ngritje të kapaciteteve, buletini dy javor, rrjetet sociale, vullnetarizmi dhe takime me artistë.

Aplikimi i punës së Artpolis shtrihet në pesë shtylla:

Shtylla I – Bashkëndërtimi i lëvizjes feministe duke sfiduar mentalitetin patriarkal në shoqëri përmes artit dhe kulturës;

Shtylla II – Avokimi dhe mobilizimi i veprimeve kolektive në mbështetje të grave, pakicave, komunitetit LGBTQI, të mbijetuarave të dhunës dhe grave që mbrojnë të drejtat e njeriut;

Shtylla III – Fuqizimi i të rinjve nëpërmjet edukimit krijues dhe alternativ për të shprehur nevojat e tyre dhe për t'i dhënë formë të ardhmes së tyre në një shoqëri që bazohet në diversitet, barazi dhe drejtësi;

Shtylla IV – Krijimi i një vendi të sigurt për gratë dhe vajzat që të shprehen përmes artit dhe kulturës;

Shtylla V - Investimi në qëndrueshmërinë financiare dhe institucionale të Artpolisit.

Aktivitetet e Artpolis janë të shtrira pothuajse në të gjitha komunat e Kosovës dhe në rajon, duke adresuar, trajtuar, ndikuar e ndërruar kufizimet e mendësisë patriarkale, duke ofruar vepra artistike e teatrore me artistë eminent të Kosovës dhe të rajonit, për qytetarët e në veçanti për të rinjtë e Kosovës; për të ngritur vetëdijen dhe angazhimin e tyre.

Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet ka një lidhje të ngushtë me mediat zyrtare të Kosovës, artistët e teatrit dhe filmit; është pjesëtare e ISPA-së (International Performing Arts Association; www.ispa.org), Rrjetit IETM, Rrjetit të Grave të Kosovës, Forumit Kulturor, CIVIKOS, Koalicionit për Shëndetin Riprodhues, Koalicioni i Kosovës për Pajtim dhe punon me artistë dhe aktivistë me prejardhje të ndryshme etnike.

RRETH RAPORTIT VJETOR 2023 TË ARTPOLIS

Viti 2023 ishte një vit sfidues për Artpolis, megjithatë kjo nuk e ka ndalur asnjërën/in prej nesh të angazhohet maksimalisht për të ndryshime pozitive në shoqërinë tonë.

Angazhimi për fuqizimin e grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara sivjet ka vazhduar përmes shfaqjeve profesionale, Festivalit FemArt, trajnimeve, punëtorive, protestave, marsheve, konferencave, diskutimeve e formave të tjera të artit dhe aktivizmit feminist.

Ky Raport bazohet në pesë shtyllat kryesore të organizatës, përmes së cilave është realizuar vizioni, misioni dhe vlerat afatgjate të organizatës. Në këtë Raport prezantohet progresi i punës, të arriturat dhe rezultatet e programit për vitin 2023. Në vazhdimësi gjeni detajet e aktiviteteve që kemi realizuar.

EDICIONI I 11-të I FESTIVALIT FEMART



Foto: Esad Duraki

Arti dhe aktivizmi ishin hapësira jonë e lirisë! Edicioni i 11-të i Festivalit FemArt, ishte edhe një herë një hapësirë e rrëfimit tonë jetësor, e kuriozitetit dhe e magjepsjes sonë të pafund.

304 artistë, aktivistë dhe staf teknikë, nga 16 shtete të ndryshme, për shtatë ditë “E dogjën frikën” duke prezantuar 28 aktivitete para më shumë se 2000 njerëzve në publik gjatë këtij edicioni të Festivalit FemArt në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Përmes artit shprehëm mendimet dhe besimet tona, e përmes diversitetit treguam se kush jemi. Dallimet tona etnike, fetare, racore e gjinore na bashkuan rreth feminizmit dhe aktivizmit tone. Rimorëm atë që na takon – jetën e përmbushur.

E kallëm tutën nga patriarkati! E kallëm tutën e paragjykimit! E kallëm tutën e dështimit! E kallëm tutën nga gjithçka që na ndalonte të lëviznim. I dhamë fund të qëndruarit një hap prapa! Bashkë e kallëm tutën! Bashkë lëvizëm një hap para! Bashkë e ndriçuam qytetin!

Në këtë edicion të FemArt, gratë artiste hapën Festivalin FemArt përmes shfaqjes “Fefu dhe Shoqet e Saj”, produksion i veçantë nga Artpolis dhe premierë në edicionin e 11-të të Festivalit. I gjithë ekipi në krijimin e kësaj shfaqje përbëhej nga artiste të dëshmuara të skenës teatrore kosovare, përfshirë këtu edhe Trupën Artistike Rezidente të Artpolis me regji të Arlinda Morinës.

Ndër të tjera publiku në Kosovë kishte rastin të shikojë shfaqjet e prezantuara në Festivalin prestig-



Foto: Esad Duraki

jioz të Avignonit; “Jogging” nga Libani dhe “Olympe dhe Unë” nga Franca, me artistët e nivelit botëror Hanane Hajj Ali, Patrick Mons dhe Veronique Ataly. Përveç tyre, pjesë e FemArt ishte Trupa Artistike nga Izraeli e udhëhequr nga një prej producenteve më të njohura në botë, Yu Jingyi, dhe aktori dhe artisti multidisiplinar Yehezkel Lazarov.

Në këtë edicion sollëm tingujt latin përmes koncertit të La Chica-s, e cila solli temperamentin dhe entuziazmin shpirtëror venezuelas, të përzier me ndikimin multikulturor, urban dhe modern parisien. La Chica ishte gëzim e dashuri e pastër. E egër dhe e lirë si deti. Muzika dhe performanca e saj është oazë në botë.

Tutje, në FemArt 11 morën pjesë artiste/ë dhe aktiviste/ë nga Sllovenia përmes shfaqjes “Pesë Llojet e Heshtjes”, me regji nga Maša Pelko, performanca teatrore “Gruaja dhe Jeta” me regji të Piotr Łukaszczyk (Poloni), “Vajzat” me regji të Milena Bogavac (Serbi), si dhe DJ Marina Mimoza (Bosnja dhe Herzegovina).

E rol të rëndësishëm kishte sivjet edhe skena artistike vendore, fuqizimi i së cilës është një nga synimet kryesore të Festivalit FemArt, që nga themelimi. FemArt, e krijuar nga gratë për gratë, hapësirë të veçantë iu jep edhe sivjet artisteve dhe aktivisteve vendore, prezantimit dhe promovimit të punëve të tyre.

Pjesë e Festivalit FemArt ishin filmat “Ka me Kalu”, me regji të Flonja Kodhelit, dhe “Vera Andron Dedin” nga Kaltrina Krasniqi. Në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar u prezantuan shfaqjet “Gratë” me regji të Nastazja Domaradzka, si dhe “Molly” me regji të Sibel Abdiu. Kurse në bashkëpunim me Teatrin e Qytetit të Prizrenit “Bekim Fehmiu” u prezantua shfaqja “Deni dhe Deti i Thellë i Kaltër” me regji të Ana Bateva.

Ndërsa tek Dispanzeri afër QKMF-së në Prishtinë u prezantua shfaqja “Sober” me regji nga Butrint Pasha, në të cilën luajtën aktorët e Trupës Artistike Rezidente të Artpolis.

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, FemArt mbajti “Kalle Tutën: Një Konferencë për Jetesë të Guximshme”, që bëri bashkë artiste/ë, aktiviste/ë dhe personalitete të shquara në tri panele diskutimi: “Përtej paragjykitimeve: Fuqizimi i grave për të tejkaluar stereotipet në vendimmarrje në art dhe në kulturë”, “Paqja dhe siguria: Kapërcimi i frikës dhe ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme”, “Thyerja e stigmës: Shëndeti mendor dhe mirëqenia në kohë sfiduese”.

Në Mitrovicë programi i FemArt u realizua në bashkëpunim me 7 Arte, si dhe Muzeun e Mitrovicës. Aty u prezantuan dokumentari dhe paneli i diskutimit “Biba May - Jo Më” produksion nga Artpolis, performanca muzikore e këngëtarit indian Soli Kapadia, shfaqja teatrore dhe diskutimi “Olympe dhe Unë”, dhe koncerti përmbyllës i FemArt në Mitrovicë nga rock grupi Ataraxia dhe dy artistët e mirënjohur Erhan Mujka dhe Anisa Suhodolli-Mujka.

Gjithëpërfshirja është një nga vlerat më të rëndësishme të Festivalit FemArt, dhe secili hap drejt fuqizimit të grupeve të marginalizuara na dërgon një hap më afër barazisë. Prandaj në këtë edicion programi i FemArt ishte i printuar edhe në alfabet të Brajtit, dedikuar për persona të verbër në Kosovë. Kjo është arritur edhe falë iniciativës së asistentes së projekteve në Artpolis, Mimoza Musliu, e cila gjithashtu krijoi një Doracak Udhëzues për qasjen e personave me aftësi të kufizuar në institucionet kulturore.

Edicioni i 11-të u përmbyll me koncertin e tre emrave të njohur në skenën e muzikës vjeneze Rina Kaçinari Trio, në përbërje të Rina Kaçinarit, Carles Muñoz Camarero dhe Jörg Mikula, me mysafir special Kori i Grave “Okarina”.

REZULTATET KRYESORE TË FEMART 11:

- **Njëzet e tetë (28) aktivitete** të organizuara
- **304 artistë/aktivistë/staf teknikë** të angazhuar në FemArt 11 (162 Gra; 139 Burra; 3 LGBTQIA+)
- **Artiste/ë dhe aktiviste/ë nga 16 shtete** (Kosova, Libani, Sllovenia, Maqedonia e Veriut, India, Franca, Venezuela, Gjermania, Serbia, Polonia, Belgjika, Izraeli, Austria, Spanja, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina)
- **Tetëmbëdhjetë (18) vullnetarë** në Prishtinë dhe Mitrovicë (12 vajza, 6 djem)
- **2064** shikuan aktivitetet e FemArt fizikisht
- **332,763** persona të arritur në të gjitha mediat sociale të FemArt
- Më shumë se **50 artikuj** të publikuar në media
- **12 blogje** të publikuara

PËRSHTYPJET E ARTISTËVE PËR FEMART 11

“ U ndjemë shumë të prekur. Kuptuam që këtu ka pasur luftë për një kohë të gjatë. Luftë në kuptimin e asaj që ju kundërviheni dhe asgjë nuk është e sigurt. E pamë këtë në Festival, me njerëzit që takuam dhe mendoj se kjo ishte një lloj baze për projektin tonë. Por siç thashë, energjinë që ke brenda vetes, luftën e brendshme, urgjencën për të bërë diçka, këtë e gjen rrallë në vendin tonë, mendoj. Urgjenca për të bërë diçka dhe pse po e bëni... Është shumë frymëzuese për ne, mendoj”, **Masa Pelko, regjisor i shfaqjes “Pesë llojet e heshtjes”, Slloveni.**

“ Ua kam zili që keni një festival kaq të madh, me kaq shumë vende pjesëmarrëse dhe kaq shumë shfaqje”, **Piotr Łukaszczuk, regjisor i shfaqjes “Gruaja dhe Jeta”, Poloni.**

“ Këta njerëz janë shumë të mirë, dhe profesionistë, është kënaqësi që jam këtu. Organizimi është shumë i mirë, si dhe çdo gjë po funksionon, ku megjithatë në të njëjtën kohë kemi pasur mundësinë të shohim shfaqje të ndryshme. **Më duket e mahnitshme”, Véronique Attaly, aktore e shfaqjes teatrore “Olympe et Moi”, Francë.**

“ Këtu mund të takosh njerëz kualitativ, jo vetëm si spektatorë, sepse e dua secilin spektator, por këta njerëz që po i takoj tani, në këtë Festival, janë të jashtëzakonshëm. (Dje) pashë cilësinë, dhe shumëllojshmërinë (e shfaqjeve)”, **Hanane Hajj Ali, aktore e shfaqjes teatrore “Vrapimi”, Liban.**

“ I shkon shumë (tema e Festivalit FemArt “Kalle tutën”). I gjithë projekti që kam shkruar, ka të bëjë me çlirimin nga frika, të shkuarja përtej kufijve, kufijve që i ke vënë vetes, përtej frikës dhe asaj që nuk të lë të shkosh më tutje. Prandaj jam në skenë. Unë jam shumë e turpshme dhe nuk do të kisha kënduar kurrë nëse nuk do të më shtynte diçka shumë e fortë, që është nevojë për t’u shprehur përmes tingujve dhe këtij instrumenti që flet për mua. Pra, është tema ajo që rezonon me mua. Dhe pasi kam kaluar trauma të ndryshme gjatë jetës, nuk kisha zgjidhje tjetër veçse të përballesh me frikën time dhe ta tejkaloj atë”, **La Chica, këngëtare nga Franca/Venezuela.**

“ Po vij në FemArt për herë të dytë dhe jam shumë e lumtur. Isha këtu rreth shtatë vjet më parë. Kjo është hera e dytë dhe jam shumë, shumë e lumtur, sepse është gjithmonë një ndjenjë e veçantë kur merr pjesë si grua në këtë Festival, por këtë vit kam ardhur me dy kolegët e mi. Për mua si femër kjo është arritje shumë e madhe, që unë po udhëheq kolegët e mi dhe jemi bashkë në skenë”, **Rina Kaçinari, violonçeliste dhe këngëtare, në një intervistë me Vjollca Durakun për KultPlus.**

“ FemArt mbylli edicionin e 11-të të tij me një thirrje për solidaritet, drejtësi e barazi. Në një kohë kur guximi, dashuria dhe përkrahja për njëri-tjetrin na duhet më shumë se kurrë më parë, drejt çlirimit njerëzor, emancipimit shoqëror dhe përbushjes personale e kolektive. Në mbylljen të Festivalit, trio i përbërë prej Rina Kaçinari-violonçelo dhe vokal, Carles Muñoz Camarero-violonçelo, nikelharpë dhe vokal dhe Jörg Mikula-bateri dhe perkusione me mysafir special kori i grave “OKARINA” solli një program gjallërues me një energji ballkanike-latine, me shtresim të zhanreve të ndryshme të kompozimeve kryesisht nga Rina Kaçinari. Ajo me trion e saj fantastike, me një plejadë të shkëlqyeshme të këngëve origjinale në shqip, me shumëllojshmëri të stileve dhe tregimeve personale publikut i ofroi përmbylljen më ngazëlluese të plot 7 ditëve dhe 28 ngjarjeve kulturore që i ofroi këtë vit festivali i FemArt”, **Albin Kurti, Kryeministër i Kosovës.**

“ Një javë arti ngazëlluese, me diskutime në panele dhe seminare nëpër ambiente në gjithë #kryeqytetin, u mbyll të hënën mbrëma me një performancë muzikore të mrekullueshme nga Rina Kaçinari , Carles Munoz Camarero dhe Jorg Mikula (trio Rina Kaçinari), si dhe nga kori Okarina, duke e përmbyllë kështu edicionin e 11-të të Festivalit FemArt, “Kalle Tutën” në Teatrin Kombëtar. Prishtina është shtëpia e një skene të larmishme dhe të gjallë feministe, me njerëz kreativë që na inkurajojnë të përqipemi vazhdimisht për marrëdhënie më autentike në mbarë shoqërinë dhe na shtyjnë të punojmë drejt drejtësisë, barazisë dhe sigurisë publike; duke avokuar për hapësira gjithëpërfshirëse, përkrahëse dhe të guximshme, që u mundësojnë individëve të shihen, të afirmohen dhe të çmohen. Më shumë se kurrë, ne e po-
hojmë mbështetjen tonë për praninë e këtyre krijuesve, të cilët, me dashuri dhe përkushtim ua ngjallin kurajon dhe fuqinë zërave që dridhen për ta kallë tutën. Tash 11 vjet organizatorja Zana Hoxha sjell talente ndërkombëtare dhe vendore në Kosovë, duke ndërthurë një program të mirëmenduar mbi përvojat e grave dhe të vajzave nga e gjithë bota. Urime Zanës dhe ArtPolis-it për këtë javë mbresëlënëse plot evente. Ju urojmë sukses dhe mirënjohje, të cilat ju i meritoni për punën e madhe që po bëni në Prishtinë e më gjerë”, **Përparim Rama, Kryetar i Prishtinës.**

MEDIAT PËR FEMART 11

“ FemArt” në tejkalim të frikës i jep zë guximit. “Kalle tutën”, si moto e sivjetme e “FemArtit”, vjen “e përkthyer” jo vetëm në aksion e thirrje, e thjeshtë për veprim. Flet qartë edhe me zërin e atyre që heshtin, por në esencë ka promovimin e guximit, si parakusht për mposhtjen e frikës. U jep “mundësi së resë, guximit dhe dashurisë që të lindin”, **Gonxhe Konjufca, KOHA.**

“ Shfaqja serbe në Kosovë i bashkon vendet në luftën e tyre kundër patriarkatit. Shfaqja teatrale serbe në festivalin ‘FemArt’ në Prishtinë, shfaq sfidat e grave dhe kërkon barazi”, **Bubulina Peni, BIRN/PRISHTINA INSIGHT.**

“ Status” në revoltë për pozitën e gruas në shoqëri. Është krejt e dallueshme revolta e saj e shprehur me lëvizje të vrazhda e të shpejta. Megjithatë, ka ngjyra dhe ato janë mjeti i reagimit të artistes Mimoza Sahiti. Me ekspozitën “Status” që vjen në kuadër të edicionit të 11-të të “FemArtit”, ajo reagon për pozitën e gruas, zbërthen qasjen ndaj identitetit e ndaj kapitalizmit”, **Besartë Elshani, KOHA.**

“ Rina Kaçinari Trio dhe Kori i Grave “Okarina” përmyllën festivalin “FemArt” me një koncert fantastik”, **Vjollca Duraku / KultPlus.**

SHFAQJET PROFESIONALE

Ansambli i Artpolis ka vazhduar me angazhime të shumta artistike edhe në vitin e tretë të ekzistencës së tij, duke prezantuar gjashtë shfaqje teatrore, dy premiera; “Fefu dhe Shoqet e Saj”, dhe “Tre 1 T’eti”, si dhe një prezantim në bashkëproduksion me Dah Teatër nga Beogradi; “Gratë Trojane – Replika”.

Për këto **6 shfaqje** të prezantuara **17 premiera/repriza** para **1467 personave në audiencë** në Kosovë, Turqi dhe Serbi u angazhuan 75 artiste/ë, aktore/ë, dhe staf teknikë.

TOP GIRLS



“Top Girls”, me regji të Shkurtë Aliut, ka vazhduar rrugëtimin artistik në vitin 2023 me tri prezantime, në: Prishtinë, Mitrovicë dhe Podujevë.

“Top Girls” është një shfaqje e vitit 1982 e dramaturges britanike Caryl Churchill. Historitë e panumërtat që Churchill paraqet në shfaqje tregojnë se çfarë presioni dhe se sa çrregulluese mund të jetë jeta e jetuar nën patriarkatin. Shfaqja tregon rolet e grave në shoqërinë moderne dhe betejat me të cilat ato përballen për të arritur sukseset në jetën e tyre profesionale, dhe për atë se çfarë do të thotë të jesh grua e suksesshme në shoqëri. Gratë nuk do të çlirohen kurrë me të vërtetë derisa të çlirohen nga kufijtë

e shoqërisë patriarkale.

Në tri prezantime “Top Girls” është ndjekur nga 105 persona në audiencë.



TOKA E SHPIRTRAVE TË TRAZUAR



E mbushur me skena dramatike, muzikë, këndim, video projeksione dhe koreografi bashkëkohore shfaqja “Toka e Shpirtrave të Trazuar” u prezantua në dy festivale gjatë vitit 2023. Më 25 janar u prezantua në Gjilan në kuadër të Flakës së Janarit, kurse më 12 mars u prezantua në Bursa të Turqisë.

Me regji të Zana Hoxhës poezitë e Shqipe Malushit u transformuan në imazhe lëvizëse. Kjo shfaqje është një rikthim mjeshtëror i kujtimeve që të shkundin qenien, e të mbajnë nën ethe për më shumë se një orë.

“ Kjo është nata e tretë që po ndjek javën e Dramës në Teatrin Kombëtar të Gjilanit. Ishte shfaqje nga ZANA HOXHA që më bëri të lotoj. Midis shumë të tjerave, shfaqja paraqiste një grua të përdhunuar, e cila po rrëfente vuajtjet e saj, por një grup burrash e tërhiqnin dhe i thoshin: “kjo nuk është e vërtetë”. Kjo në një fazë është Serbia që ka kryer krime dhe krime lufte kundër njerëzimit (duke përfshirë përdhunimin e mbi 20000 grave) dhe vazhdimisht refuzoi të pranonte krimet e tyre për 24 vjet tani. Fatkeqësisht, po kjo skenë shpalos situatën e shoqërisë patriarkale dhe seksiste të (disa shumë burrave të Kosovës), që dhunon gratë, i keqtrajton ato, i sheh si objekte seksi dhe refuzon të pranohet se e kanë gabim dhe se mënyra e tyre e të menduarit dhe e veprimit është një krim. Akoma më keq, unë para se ta shihja këtë shfaqje të artit bashkëkohor, lexova se

një gjykatë në Kosovë liroi pesë burra të cilët akuzohen për përdhunimin e një fëmije 11 vjeçar. Jam i shqetësuar. Dhe i jam mirënjohës Zana HOXHA-s dhe trupës së saj që me guxim e sollën këtë shfaqje për t'u siguruar që shoqëria jonë të përballet përmes artit me pasojat e mosveprimeve dhe veprimeve të saj”, Vudi Xhymshiti, fotoreporter / 25.01.2023 / Facebook.

“ ...Regjia është fjala e fundit e kësaj shfaqjeje. Më la shumë mbresa. Pashë në nivelet më të epërme, llojin e teatrit poetik. Pamë gërshetim të mirë të tekstit poetik, muzikës, koreografisë. Modeli dhe episodi i dashurisë si dallgë, diçka fantastike, tupani, tamburet, klithmat, mitet që na bërtasin e na thonë ti je ky, ruaje këtë identitet që ke... Është metaforë teatrore e ngritur në koreografi, muzikë, imazh dhe tekst poetik, të gjitha të harmonizuara shumë bukur. Ky lloj arti krijon magji. Nuk është këtu teatri i fjalës. Shumë gjëra kuptojmë nëpërmes lëvizjes, pikturës, vallëzimit... Atdheu është te shtëpia ime. Këtu jemi në art. Nuk jemi në publicistikë, jubilarë, histori. Teksti është poetik. Ka dashurinë për shtëpinë, atdheun, fëmijërinë...”, Josif Papagjoni, autor i dhjetëra librave për teatër e dramë.

Mbi 640 persona kanë shikuar “Tokën e Shpirtrave të Trazuar” në këto dy prezantime.

SOBER



Foto: Esad Duraki

Shfaqja teatrale “Sober”, me regji të Butrint Pashës, produksion i Artpolis, ka rrëmbyer **dy çmime të rëndësishme në edicionin e 53-të të Festivalit të Teatrove në Ferizaj. Me Çmimin Special u shpërblye regjisori Butrint Pasha, derisa Zhaneta Xhemajli mori Çmimin “Yll në Ardhje”.**

Më 29 gusht, 2023 hapësira e Kinemasë së Qytetit u shndërrua në një “qendër rehabilitimi nga varësitë”. Audiencia pati rastin të përjetojë ngjarje trishtuese dhe prekëse, momente të qeshurash e histori inspiruese për triumfin e njerëzve ndaj varësive që marrin çdo ditë jetë. Performanca e Ansambllit të Artpolis, me mesazhe prekëse, depërtoi thellë në mendjen e të pranishmëve dhe shfaqja u mbyll me duartrokitje dhe emocione nga publiku në Ferizaj.

“Sober”, e cila bazohet në veprën e Duncan MacMillan “Njerëz, vende dhe gjëra”, është një histori suksesi ku një njeri arrin të mposhtë varësinë ndaj drogës, fenomenit botëror që në vazhdimë-

si vret njerëz dhe shkatërron familje. E bazuar në një ngjarje sentimentale të një vajze që vuan nga alkoolizmi dhe varësia ndaj drogës që po rehabilitohet në një qendër, Ema vjen si personifikim i shumë njerëzve të stigmatizuar nga shoqëria për shkak të pasigurisë që i është krijuar nga varësia, që ka ndikuar edhe në karakterin e saj.

Përveç prezantimit në Ferizaj, “Sober” është dhënë pesë herë edhe tek Dispanzeri, afër QKMF-së në Prishtinë, në prani të 162 personave në audiencë gjatë gjashtë prezantimeve.



FEFU DHE SHOQET E SAJ



“Fefu dhe Shoqet e Saj”, me regji të Arlinda Morinës, ishte produksion i ri i Artpolis më 2023. Artiste gra u mblodhën për të sjellë para audiencës një vështrim të thellë të botës së grave, temën e barazisë gjinore, e mbi të gjitha shpalosën rrëfime emocionuese mbi rolin e gruas brenda sistemit patriarkal, e domosdoshmërisë së saj për liri.

Kjo shfaqje shpërfaq edhe çështje të pritshmërisë së shoqërisë ndaj grave, padrejtësitë e pushtetit dhe sfidat e grave për ta gjetur veten në një shoqëri të mbushur me pabarazi. “Fefu dhe Shoqet e Saj”, me autorësi të Julies Aaron dhe Maria Irene Fornes, ofron një dritare të rëndësishme të shtypjes së patriarkatit dhe çlirimit përmes feminizmit, dhe na bën të reflektojmë mbi normat dhe strukturat shoqërore që pengojnë barazinë gjinore.

“Fefu dhe Shoqet e Saj”, produksion i Artpolis, shënoi kulminacionin pikërisht në momentin kur gratë

bashkuan forcat, dhe njëzëri protestuan kundrejt shtypjes, patriarkatit e dhunës së shumëfishtë. Fefu (Aurita Agushi), Cindy (Zhaneta Xhemajli), Christina (Qendresa Kajtazi), Juli (Donikë Ahmeti), Ema (Vlora Dervishi), Cecilia (Blerta Gubetini), Paula (Dora Xhemajli) u bashkuan në solidaritet me të gjitha gratë duke kënduar “Po na vjen behari’ – po përmbysët patriarkati, liria po vjen, s’ka pushtet që mbrapa ne na kthen, shtypjes suaj fundi po i vjen!”.

Teksa këndonin ato valëvisnin edhe flamujt e komuniteteve të LGBTQI+. Një përjetim i tillë teatror na inkurajon të reflektojmë mbi diversitetin dhe dallimet brenda shoqërisë, duke bërë thirrje të angazhohemi përditshëm drejt një shoqërie më të hapur dhe të drejtë.

Kjo shfaqje ka hapur edhe edicionin e 11-të të Festivalit FemArt, dhe në tri prezantime është ndjekur nga më shumë se 400 persona në audience.

GRATË TROJANE – REPLIKA



Më 23 Nëntor 2023, Teatri Dodona u shndërrua në hapësirë të rrëfimit të përjetshëm të vuajtjes njerëzore, teksa “Gratë Trojane – Replika” shpalo-si sagën e tragjedit, që nga Troja deri në botën moderne. Dëshpërimi i Euripidit jehoi përgjatë performancës, duke na kujtuar se thelbi i Trojës, me dhimbjen dhe dhunën e saj, ende përshkon realitetin tonë global. “Troja ende është kudo,” thërret Euripidi, teksa tërheq paralele therëse, “e gjithë bota është Troja jonë e lashtë dhe Troja juaj moderne. Mijëra kuaj, jo nga druri, por nga çeliku... që fluturojnë. Pegasus të hekurt që hedhin bomba kudo”.

Drejtuar nga regjisoret feministe Zana Hoxha dhe Dijana Milosheviq, dhe e përjetësuar nga Ansamblet e talentuara të Artpolis dhe Dah Teatrit, ky produksion dygjuhësor, në shqip dhe serbisht, shpërfaq vuajtjet e grave si pasojë e luftërave. Prezantimi ishte një kujtesë e përjetshme për ta bërë prioritet paqen, e për të thyer ciklin e konflikteve në avokim të zërave të grave. Përmes këtij bashkëpunimi Artpolis dhe Teatri Dah kapërcyen barrierat kombëtare, duke krijuar

një hapësirë të sigurt për të demonstruar fuqinë e artit, siç shprehet edhe Hoxha: “Sinergjia e krijuar mes nesh si artiste dhe kolektive feministe kapërcen barrierat kombëtare dhe gjuhësore, dhe krijoi një hapësirë që fuqia e teatrit të ndikojë në mendjet dhe zemrat tona duke krijuar një zonë të sigurt për një përvojë të përbashkët”.

Dy gjuhësia, larg nga pengimi i të kuptuarit, u bë urë lidhëse duke vënë në pah rezonimin universal të këtij prezantimi, siç u shpreh edhe një person nga audienca, “Unë nuk e kuptoj gjuhën serbe, por e kuptova të gjithë prezantimin, sepse lufta është po aq e keqe në çdo cep të botës; sepse dhimbja nuk ka nevojë për përkthim; por edhe sepse arti është gjuha universale e kësaj bote”.

“Gratë Trojane – Replika”, që është në proces krijues, është prezantuar edhe në Beograd më 8 shtator, duke u prezantuar para 110 personave në audiencë në këto dy prezantime.

TRE 1 T'ETI (T'THYMË)



Foto: Esad Duraki

Me premierën e shfaqjes dans teatër “Tre 1 T’eti” Artpolis ka lëshuar perdet teatrore më 27 dhjetor, 2023 nw Teatrin Dodona. “Tre 1 T’eti” është kërkimi më i fundit konceptual, koreografik e teatror i koreografit Robert Nuha me Ansamblin artistik të Artpolis. Në ndërthurje të satirës, dansit bashkëkohorë dhe dramës “Tre 1 T’eti” vuri në pah maskulinitetin toksik të burrave të krijuar ndër shekuj nga sistemi patriarkal, e shtypjen sistematike ndaj grave.

“Tre 1 T’eti” ngre pyetje pa tentuar të japë përgjigje, atë ia lë publikut që të reflektojë. Në një lojë komplekse teatrore, personazhet transformohen, udhëtojnë në kohë e thellohen në gjurmim personal në kërkim të përgjigjeve. Patriarkati e feminizmi janë botëkuptimet që përplasen gjatë tërë kohës. Mjeshtërisht, Nuha ka jetësuar dy personazhet kryesore, babanë dhe vajzën, të cilët nuk inskenohen fizikisht, por janë thelbi i shfaqjes. Ata jetësohen përmes rrëfimeve të tre vëllezërve që luhen nga aktorët e Artpolis, Edlir Gashi, Labinot Raci dhe Mikel Markaj.

Maskuliniteti toksik zë vend në secilën skenë të shfaqjes. Ai shpërfaqet qysh në skenën e parë. Tre vëllezër ngushëllojnë njëri-tjetrit për vdekjen e babës, të tre i japin kurajë njëri-tjetrit, “mos kaj, bonu burrë”, “bonu burrë, mos kaj si çikë”, “rri drejt, mos ec si çikë”, “burri është burrë!”. Për të vazhduar më pas me përplasjen e binjakëve, njëri dy minuta më i madh se tjetri, si element i hierarkisë dhe maskulinitetit toksik të mbjellura nga patriarkati.

Prona dhe trashëgimia e babait përplas vëllezërit. Ata refuzojnë të bëjnë ndarje të barabartë, e aq më pak për motrën e tyre. Kjo përplasje i çon në varrin e babait të tyre, aty ku marrin unazën e tij. Përmes unazës personazhet transformohen, e udhëtojnë në kohë, duke gjurmuar këtë problematikë të patriarkatit në gjenezë. Në skenë vijnë edhe Zeusi, Hadi e Posiedoni, që ironikisht përballen me problemet e njëjta të tre vëllezërve në tokë – ndarjen e trashëgimisë, dhe lakminë për pushtet.

Për shkak të vendeve të limituara, premierën e kësaj shfaqje e ndoqën 50 persona në audiencë.

FONDI PËR ART FEMINIST



10 vepra artistike me qasje feministe janë prezantuar sivjet në kuadër të Fondit për Art Feminist të Qendrës për Art dhe Komunitet – Artpolis, përmes së cilës janë mbështetur 29 artiste/ë.

Performanca, shfaqje teatrore, mbrëmje poetike, botime libri, koncerte, e forma të tjera artistike u prezantuan nga artiste/ë dhe grupe artistike përgjatë vitit 2023. Në 13 prezantime, këto vepra u ndoqën nga 620 persona në audiencë.



KONCERT SOLISTIK NGA SOPRANOJA URTA HAZIRAJ



Foto: Enes Sahiti

Sopranoja Urta Haziraj, më 23 shkurt, ka sjellë para publikut muzikën klasike të periudhave të ndryshme, duke filluar nga klasicizmi, romantizmi, e deri tek ato bashkëkohore.

Koncerti Solistik i saj ka zënë vend në kishën Shën Ndou në Prishtinë, dhe është ndjekur nga më shumë se 150 persona në audiencë. Përmes këtij koncerti Urta ka inkurajuar që muzika klasike në Kosovë të ndiqet edhe më shumë, e të ketë shtrirje edhe më të gjerë.

Bashkë me Urtën, në skenë ishin edhe muzicentë e performuesit Visar Kuçi, Milot Mehmeti, dhe Lirika Pula Kasapolli, të cilët sollën pjesë të ndryshme

të muzikës klasike, përfshirë këtu edhe “Der kleine Sandmann bin ich” të Engelbert Humperdinckit, L’amerò, sarò costante” të Mozartit apo “I Feel Pretty” nga Leonard Bernstein.



Foto: Enes Sahiti

VLORA ADEMI SJELL LIBRIN “KATËRDHETË E PAK”




Foto: Ferdi Limani

Mbrëmjen e 24 marsit në Kino Armata është promovuar libri “Katërdhetë e pak” i autores Vlora Ademi. “Katërdhetë e pak” u përcoll edhe me një panel diskutimi, recitim poezish e muzikë.

Panli ishte në përbërje të Primo Shllaku, Agim Baçi dhe Gazmend Bërlajolli dhe ishte udhëhequr nga regjisorja Zana Hoxha. Aktorja Meli Qena interpretoi disa nga poezitë e Vlora Ademit, kurse për muzikën u përkujdesën Elikona Hysaj Shala dhe Astrit Stafai. “Katërdhetë e pak” vjen si një rrëfim personal i autores Vlora Ademi, të cilat i ka krijuar për një kohë të gjatë e me shumë dashuri. “Nuk mundem me tregue me saktësi kur kam fillue me e shkruje poezinë, por mundem me thanë se, pavetëdijshëm, kam ardhë në kohën, kur mjaftueshëm kam pas të deponuem

material për të. Mjaftueshëm kur e kam kuptue se, tuj e shpërfaq emocionin dhe ndjeshmëninë, poezia kumton njohuni dhe vlera njerëzore”, ka shkruar Vlora në rrjetet e saj sociale për promovimin e librit.



“UNË DHE UNË” NGA FLAKA LATIFI, NJË RRËFIM NJERËZOR PËR QËNDRUESHMËRINË



Skena e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës mbrëmjen e 25 marsit, 2023 “u pushtua” nga aktorja Flaka Latifi, e cila solli performancën “Unë dhe Unë”.

“Unë dhe Unë”, ishte një udhëtim dashurie, ndërthurje emocionesh që shpalosi para së gjithash gjendjen njerëzore përmes të qeshurës, gëzimit, vuajtjeve e zemërimit.

Loja skenike e Flakës mbizotëron në këtë performancë të inspiruar nga “Pulëbardha” e Anton Çehovit. Monologjet dhe “dialogjet” në skenë i realizon krejtësisht e vetme, dhe përmes lëvizjes së trupit Flaka solli personazhe të ndryshme që komunikuan me audiencën.

“Unë dhe Unë” ishte një rrëfim njerëzor për qëndrueshmërinë ndaj sfidave që na godasin gjatë tërë jetës.



AGNES NOKSHIQI SJELL PERFORMANCËN “IN BETWEEN”



E vërteta e thënë zëshëm, hap rrugë për humanizëm dhe mirëkuptim! Ky ishte mesazhi që përcolli artistja e mirënjohur Agnes Nokshiqi përmes performancës së saj të fundit “In Between”. Të martën mbrëma, më 13 qershor, 2023 publiku ishte mbledhur në katin përdhësë të Bubble Pub, për të përcjellë këtë shfaqje intime, që bënte fjalë për të kaluarën e një gruaje të sprovuar nga jeta. I vendosur brenda hapësirës skenike publiku u bë pjesë aktive e ngjarjes.

Performanca shpirtërore e Agnesit, me pak lëvizje, i ngjante impulseve të mëdha të ndjenjës origjinale që kishte për qëllim të krijonte kjo performancë. Kryesisht e shtrirë dhe e lodhur Agnesi për pesëdhjetë minuta arriti të prezentonte metafora të dhimbjes, një shpërfaqje e dhimbjes njerëzore, sfidave e pikëpyetjeve të mëdha drejt njohjes së vetes.

Në pjesën e dytë të shfaqjes ajo filloi të bënte pyetje personale për të pranishmit, si: “Për çka jeni pishman?”, “Cili moment i jetës tënde të definon ty?”, “A

je gati me tregu me trup ato që nuk mundesh me i thonë me fjalë?”. Të mbërthyer nga personalja e tyre, publiku u përgjigj në mënyrën më të sinqertë, që rezultoi me përfaqime të gjata me aktoren në skenë, që në fund la shijen dhe mesazhin që e vërteta e thënë zëshëm, hap rrugë për humanizëm dhe mirëkuptim!



LEXIMI SKENIK “REDLIGHT ON SUNDAY”



Më 27 qershor, 2023 në Teatrin Dodona u realizua edhe projekti i radhës nga Artpolis, në kuadër të Fondit për Art Feminist – leximi skenik “Redlight on Sunday” me autor Butrint Pasha.

Kjo dramë u interpretua nga aktorët Adrian Morina dhe Zana Berisha, të cilët portretizuan personazhet e profesor Mudit dhe Linës, studente në fazën finale të diplomimit. Ngjarja zë vend në Universitet, përmes së cilës u paraqit ngacmimi seksual si fenomen negativ në rritje.

Një dramë një-aktëshe që përmban dialog të ndjeshëm ku personazhet janë në kërkim të përbushjes së qëllimeve të tyre, ku njëra rrugë çon te një përdhunim si rezultat, ndërsa tjetra e hedh para drejtësisë një ngacmues tjetër. E mbushur me dia-

log të mprehtë, cinik dhe ngacmues nga rrethanat e krijuara prej profesor Mudit, na mbajtën pezull duke menduar më të keqen, për fatin e kësaj studenteje njëzet e dy vjeçare.



“BREAK/ING”, NJË AKT I DASHURISË PËR VETEN



Më 14 tetor, artistja, Uresa Ahmeti ka dhënë premierë performancën e saj “Break/ing” në Parkun e Qytetit në Prishtinë. Nuk ishte asgjë më pak se një udhëtim magjepsës nëpër thellësitë e shpirtit njerëzor, një akt i emërimit të shtypjes dhe një testament prekës i fuqisë së artit. Nëpërmjet poezisë, vallëzimit dhe muzikës, ajo e çoi audiencën nga përjetimi i dhimbjes në vetë-realizim, ndjeshmëri dhe dashuri radikale.

Ajo filloi duke ndërtuar një atmosferë therëse të izolimit dhe ndjenjës së të qenit e lidhur me zinxhirë, dhe gjatë gjithë performancës së saj, me fjalët dhe lëvizjet e saj, ngadalë u shkëput nga guaska e saj – një simbol i kufizimeve të shoqërisë ndaj grupeve të

margjinalizuara. Lëvizjet e saj u bënë më të shpejta dhe më të lira. Ritmi i saj iu kujtoi të gjithëve aftësinë e trupave tanë për lumturi dhe rezistencë.



“JEPI NGJYRA JETËS”, ME RRËFIME PERSONALE PËR FUQIZIM TË GRAVE




Përmes rrëfimeve personale dhe fiktive, aktoret Anisa Ismaili dhe Fitore Broqi më 28 shtator, 2023 sollën performancën “Jepi Ngjyra Jetës”, si thirrje për emancipim shoqëror e fuqizim të gruas.

E prezantuar në Teatrin Oda, “Jepi Ngjyra Jetës” vuri në qendër të vëmëndjes gruan, sfidat e saj dhe ballafaqimin me paragjykimet dhe normat e sistemit patriarkal. Ëndrrat, dëshirat, dhe guximi i grave u shpalosën me kreativitet në këtë performancë me elemente tradicionale minimaliste. Rrëfimet e ndryshme të Anisës dhe Fitores u pasuruan me video projeksionet e krijuara nga Mersime Ademi, si narracion për traumat dhe plagët e shkaktuara nga patriarkati.

“Jepi Ngjyra Jetës” u prezantua edhe në Podujevë, Pejë dhe Fushë Kosovë, në prani të 230 personave.



MURALI KUNDËR DHUNËS DHE VRASJES SË GRAVE



Shkolla fillore “Idriz Barani” në Klinë të Epërme të Skenderajt është shndërruar në një hapësirë të avokimit dhe ngritjes së vetëdijes shoqërore kundër vrasjes dhe dhunës ndaj grave.

“Unë nuk jam pronë e askujt. Vetëm edhe një shuplakë është dhunë” është titulli i muralit që është prezantuar në këtë shkollë më 29 nëntor, 2023. Realizuar nga OJQ Humanus Vita dhe artisti Nazmi Kyqyku, ky mural është prezantuar në kuadër të “16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, me mbështetje të Fondit për Art Feminist të Artpolis.

Doruntina Gashi, drejtore e Humanus Vita, ka thënë se edukimi i të rinjve dhe ngritja e vetëdijes tek ta për fenomenet e dhunës në shoqërinë tonë është i një rëndësie të veçantë. Për të, është ende shqetë-

suese dhuna dhe vrasja e grave.

Nxënës të shkollës “Idriz Barani” kanë lexuar disa nga thirrjet kryesore të mesazheve që përcjell ky mural: Stop Femicidit, Raporto 192, Mos e ndal çikën/edukoje djalin, #BollMa etj.



“EDI: LABIRINTI DARDAN DHE PORTA E TUKANËS”, HOMAZH PËR EDI SHUKRIUN



Më 5 dhjetor, në hapësirën e Dit' e Nat' Kaltrina Igrishta e Eliza Shala kanë promovuar librin e tyre të veçantë me ilustrime “Edi: Labirinti Dardan dhe Porta e Tukanës”, një homazh jetës dhe veprës së arkeologes së shquar Edi Shkuriu.

Në ndërthurje të tregimeve të shkruara nga Igrishta, dhe ilustrimeve të Shalës libri komik “Edi: Labirinti Dardan dhe Porta e Tukanës” është një udhëtim në kohë i Edi Shkuriut, sa dramatik aq edhe inspiruese për punën dhe angazhimin e saj ndër vite.

Igrishta dhe Shala qëllimshëm kanë vendosur që këtë libër ta promovojnë pikërisht në kuadër të “16 Ditëve të Aktivizmit”, për të festuar fuqinë e gruas dhe angazhimet e tyre për emancipim shoqëror. Ky tregim fantastiko-shkencor në librin “Edi: Labirin-

ti Dardan dhe Porta e Tukanës” jo vetëm që shfaq mrekullitë e eksplorimit arkeologjik, por gjithashtu thur një histori të forcës dhe këmbënguljes së grave, përtej sfidave brenda sistemit patriarkal.



“BE AWARE: PATRIARCHY DESTROY ZONE”, GODET FEMICIDIN DHE FTON GRATË NË SOLIDARITET



Më 9 dhjetor, Blerta Gubetini e Dora Xhemajli sollën performancën e tyre “Be Aware: Patriarchy Destroy Zone” në skenën e Fakultetit të Arteve në Prishtinë.

E prezantuar në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit” kjo performancë ishte një thirrje kundër shtypjes sistematike të grave nga patriarkati, e thirrje që vrasja e grave të ndalet. Me ndërthurje të disa prej ngjarjeve më të rëndësishme feministe “Be Aware: Patriarchy Destroy Zone” është një performancë feministe që godet seksizmin, mizogjeninë e femicidin, dhe fton gratë në solidaritet.

Performanca nisi me skena të protestave të grave në rrugë nga Kili në Washington, nga Parisi në Prishtinë, që njëzëri i kishin thënë stop vrasjes dhe dhunimit

të grave përmes performancës “Un Violador en Tu Camino (Një përdhunues në rrugën tënde)” të krijuar nga Las Tesis. Më pas në skenë paraqitet Dori Xhemajli, e cila solli monologun e shkrimtares së parë feministe Christine de Pizan si thirrje për edukimin e grave, e drejtë e mohuar ndër shekuj. Në këtë performancë kanë zënë vend edhe kënga e Beyonce “Flawless”, e marshi “BollMa” nga Artpolis.

Inspiruar nga performanca “Interior Scroll” e Carolee Schneemann, Blerta Gubetini sfidoi normat shoqërore duke eksploruar temat e feminitetit, seksualitetit dhe artit. Akti i guximshëm dhe provokues për të nxjerrë një letër nga vagina e saj ndërsa e lexon me zë të lartë, sfidon nocionet tradicionale mbi trupin e grave.

ARTIVIZMI FEMINIST

Arti dhe aktivizmi kanë qënë binomi i punës së Artpolis kundrejt shtypjes së patriarkatit dhe femicidit edhe më 2023. Me protesta, marshe, konferenca, performanca e publikime të ndryshme Artpolis ka ngritur zërin kundër mizogjenisë e vrasjes së grave.

POEZI PËR FUQI – ÇDO DITË ËSHTË 8 MARS



Foto: Esad Duraki

Solidariteti bashkon gratë. Të bashkuara ato in-spirojnë, edukojnë dhe guxojnë. E mbrëmja po-etike “Poezi për Fuqi – Çdo ditë është 8 Mars” bëri bashkë 31 artistë/e të dëshmuar/a dhe aktiviste/ë të zhanreve, gjinive, e etnive të ndryshme.

Me diversitet artistësh shqiptarë, romë, serbë, francez dhe nën udhëheqjen e Ansambllit të Artpolis u shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas në Menzën Ramiz Sadiku, më 2 mars, 2023 në Prishtinë. Kjo mbrëmje ishte një solidarizim me tri gra kryefamiljare nga Klina, Skenderaj, dhe Mitrovica, qytete këto të prekura nga vërshimet.

Mbrëmja nisi me poetet/ët e kësaj mbrëmje Sibel Halimi, Arbër Selmani, Gili Hoxhaj e Shpëtim Selmani, të cilat/ët sollën poezitë e tyre të bukura para publikut, që në përbërje kishte personalitete të shquara

të artit, aktivizmit dhe politikës në Kosovë.

120 persona patën rastin të ndjekin këtë mbrëmje të veçantë artistike të poezisë.



Foto: Esad Duraki

MARSHOJMË S'FESTOJMË



Edhe këtë vit shënuam 8 Marsin me protestë gjatë marshit tradicional, duke përshkruar rrugët e Prishtinës, nga Pallati i Drejtësisë për të arritur në sheshin “Zahir Pajaziti” ku aktiviste e aktivistë nën brohoritje, këngë, zhurma e fishkëllima u bashkuan për të vazhduar rrugëtimin deri te ndërtesa e Qeverisë.

Me brohoritjet “Poshtë qeveria patriarkale”, “Kush na mbron nga policia”, “Edhe sa thirrje të humbura”, “Edhe sa gra të vrara”, “Poshtë prokuroria patriarkale”, “Poshtë policia patriarkale”, “Vrasjet e grave janë të paralajmëruara”, “Gjykata i ka duart me gjakun e grave”, etj, marshuam rrugëve të Prishtinës në protestë kundër sistemit shtypës patriarkal, i cili në vazhdimësi dështon t’i mbrojë vajzat e gratë nga dhuna dhe vrasjet.

Bashkë marshuam për të shprehur revoltën ndaj dhunës me bazë gjinore. Duke filluar nga organizimi

me bazë gjinore i punës dhe feminizimi i varfërisë, dhunës seksuale, psikologjike e fizike e deri tek dhuna e institucionalizuar e cila vazhdon t’i shtypë gratë në mënyrë asimetrike duke i shndërruar në subjekte më të cenueshme dhe më të varfra.



PROTESTA “SHTETI FAJTOR PËR VRASJEN E SEBAHATE MORINËS”



Foto: Esad Duraki

Më 4 dhe 5 Prill 2023, një grup prej 65 aktivistesh organizuan një aksion proteste nën moton “Shteti është fajtor për vrasjen e Sebahate Morinës”.

Kjo protestë erdhi si kundërpërgjigje ndaj neglizhencës së institucioneve për shkarkimin dhe dënimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi për shkeljet në rastin e Sebahate Morinës dhe të Prokurorit përgjegjës për trajtimin e shkeljes së të drejtës në jetë të Sebahate Morinës.

Kjo protestë erdhi dy javë nga nxjerrja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese që i gjeti përgjegjës Prokuroren dhe Policinë për shkeljen e të drejtës në jetë të Sebahate Morinës.

Falë protestave të forta të shoqërisë civile, Kryeprokuroria e Shtetit u detyrua të ndërmarrë veprime

dhe të fillojë procedurë disiplinore ndaj prokurores së përfshirë në rastin e Sebahate Morinës. Përpjekjet kolektive të këtyre aktivistëve luajtën një rol vendimtar në kërkimin e drejtësisë dhe mbajtjen e përgjegjësve për vrasjen e saj.



Foto: Esad Duraki

#BOLL MA! STOP FEMICIDIT & HOPE BUBBLE



Foto: Esad Duraki

Më 07.12.2023, i thamë “Stop Femicidit” përmes marshit marshit “Boll Ma” dhe performancës artistike “Hope Bubble”, teksa kërkuam drejtësi për Liridona Ademajn, dhe të gjitha gratë e vrara deri më tani.

“Sot jemi mbledhur këtu për t’i thënë stop femicidit, për t’i thënë stop vrasjes së grave dhe shtypjes së tyre. Sot kërkojmë drejtësi për Liridonën, e për të gjitha gratë e vrara. Kërkojmë dënim maksimal për kriminelët, përkitazi me ligjin”, ka thënë Nertila Qarri-Gërguri, menaxhere e projekteve në Artpolis në deklaratën për media.

Ajo ka shtuar se femicidi është urgjencë kombëtare. Prandaj, është momenti i fundit t’i japim fund femicidit, “është momenti i fundit të sjellim drejtësi, e barazi gjinore. Është momenti i fundit t’i japim fund patriarkatit, e bashkë me të edhe shtypjes”.

Femicidi, mizogjenia e maskuliniteti toksik vazhdojnë të na terrorizojnë përditshëm. Jeta e grave ceno-

het çdo ditë, në shtëpi, në rrugë, në punë, në hapësira publike e private.

E përmes performancës së saj “Hope Bubble”, Donikë Ahmeti ka sjellë përditshmërinë e grave, shtypjen e shumëfishtë dhe sistematike të patriarkatit, që vret çdo ditë gratë. Altina Binaku, Lavdiye Idrizi, Meri Gojani dhe Albionë Sahiti sollën në jetë këtë performancë, mbështetur nga 30 të rinj dhe të reja që ishin pjesë e kësaj performace.



V, ZË I NDRYSHIMIT QË FRYMËZON FEMINISTET



Foto: Esad Duraki

Mbrëmja artistike me V (ish Eve Ensler), që u mbajt më 21 nëntor, 2023 u shpalo si një lulëzim delikat, petalet e fuqizimit u shpalosën një nga një – një mishërim i qëndrueshmërisë, artit, avokimit dhe aktivizmit. Mbrëmja u organizua nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet. Ndërsa publiku hynte në amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, ajri gumëzhinte nga pritja, një rrymim i emocioneve të përbashkëta përshkonte dhomën.

Teksa dritat në publik u zbehën, aktorja Zhaneta Xhemajli nga Ansambli i Artpolis qëndronte në qendër të skenës, e ndriçuar nga një dritë e butë. Me një zë që thurte fjalët në një tapiceri emocionesh, ajo filloi të recitonte poezinë e V-së “Manifest për gra dhe vajza” nga vepra “Unë jam një krijesë emocionale” – një vallëzim lirik që eksploronte ndërlikimet e gruas. Publiku, i rrëmbyer nga ritmi i vargjeve, ndjeu se fuqia e gjuhës i kapërcen kufijtë e fjalëve të thjeshta. Poema, si një klithmë kumbuese, vendosi tonin e mbrëmjes.

Pas performancës poetike, V u angazhua në një diskutim të moderuar nga Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive e Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, duke eksploruar nuancat e artit dhe aktivizmit feminist. Dialogu i tyre ishte një valle idesh, koreografi mendimesh dhe pasioni, një bisedë e thellë mes aktivisteve feministe. Vështrimi i V-së, i lindur nga një jetë e tërë avokimi, pikturoi një portret të gjallë të luftës së vazhdueshme për barazi gjinore. Publiku dëgjoi me vëmendje të lartë, çdo fjalë e saj ishte si një lëvizje brushe në pëlhurën e mirëkuptimit.

Derisa diskutimi zhvillohej, publiku u bë pjesëmarrës aktiv i kësaj mbrëmje. Pyetjet, si yje vezulluese zinin vend, duke ndriçuar thellësinë e kuriozitetit dhe urinë për ndryshim. V u përgjigjej me elokuencë dhe çiltërsi, fjalët e saj jehonin nëpër hapësirë si një mantra fuqizimi.

“Ëndrra është gjallë...Ne kemi fuqinë të rimarrim botën. Do të vazhdojmë derisa t'i japim fund dhunës”, V

Fundi i mbrëmjes u afrua me një performancë të dytë poetike, këtë herë nga Donikë Ahmeti nga Ansambli i Artpolisit që interpretoi “Të thërras trup” nga V, një poezi që feston bukurinë dhe cenueshmërinë e formës njerëzore, duke e njohur trupin jo thjesht si një entitet fizik, por si një enë që mbart histori, qëndrueshmëri dhe thelbin e qenies.



PUBLIKIMI I RAPORTIT HULUMTUES RRETH NGACMIMEVE SEKSUALE NË UP



Më 20 nëntor, 2023 Artpolis publikoi raportin hulomtues “Analizë e njohurive të studentëve mbi ekzistencën dhe zbatimin e Rregullores kundër ngacmimit seksual dhe ngacmimit në Universitetin e Prishtinës”, me autore Ariana Qosaj-Mustafa.

Raporti fokusohet në analizën e Universitetit të Prishtinës dhe niveleve ekzistuese të reagimit në zbatimin e Rregullores kundër ngacmimit seksual duke qenë Universiteti më i madh në Kosovë si dhe universiteti i parë që ka miratuar një rregullore specifike për adresimin e rasteve të raportimit të ngacmimeve seksuale dhe ngacmimeve brenda universiteteve publike.

Që nga miratimi i Rregullores, në maj të vitit 2021, Zyra për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual dhe ngacmimi ka pranuar në total pesë (5) raporte me pretendime për ngacmime seksuale, prej të cilave tri (3) u dorëzuan fizikisht dhe dy (2) në formë elektronike. Rastet e raportuara janë deleguar sipas procedurës së përcaktuar nga rregullorja

e Komisionit të Këshillit të Etikës për procesim dhe trajtim të rasteve. Këshilli i Etikës gjatë muajit maj 2023 ka vendosur që dy prej këtyre rasteve janë të pabazuara, për arsye se raportet u dërguan nëpërmjet shkresave elektronike anonime. Komisioni, sipas procedurës për ekzaminim të rasteve, i fton palët në një seancë dëgjimi me qëllim të prezantimit të të gjitha fakteve. Me këtë rast kjo nuk ishte e mundur për shkak se raportimi u bë nëpërmjet shkresave elektronike anonime, dhe kështu nuk kishte mundësi që palës ankuese t’i dërgohet ftesa për seancë dëgjimi.

Gjatë prezantimit të metodologjisë dhe gjetjeve e rekomandimeve kryesore të këtij raporti Ariana Qosaj-Mustafa ka thënë se ende është shkallë shumë e lartë e mosraportimit të rasteve për shkak të mungesës së besimit nga studentet se institucionet do të ndërmarrin masat e duhura ndëshkuese ndaj kryerësve të veprave.

SESIONET INFORMUESE PËR RREGULLOREN NË UP



Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet së bashku me zyratën për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, Drita Hyseni, kanë mbajtur 10 sesione informuese për adresimin e ngacmimeve dhe ngacmimeve seksuale gjatë periudhës tetor – nëntor, 2023.

Hyseni dhe përfaqësuesi i Artpolis, Mërgim Memović, menaxher i projekteve, kanë informuar studentet/ët për “Rregulloren kundër Ngacmimeve Seksuale brenda Universitetit të Prishtinës”, mënyrës së raportimit të rasteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit pas raportimit. Gjithashtu, kanë diskutuar se çka është ngacmimi seksual, format e ngacimit seksual si dhe sjelljet të cilat konsiderohen ngacmim seksual.

NATA E FILMIT NË ARTPOLIS NXIT DISKUTIM MBI NGACMIMET SEKSUALE



Në mbrëmjen e 15 marsit zyra e Artpolis u shndërrua në një kinema të vogël. Të rinj dhe të reja u mbledhën për shikuar dhe diskutuar mbi filmin “She Said” me regji të Maria Schrader dhe skenar të Rebecca Lenkiewicz.

“She Said”, trajton historinë e vërtetë e dy gazetareve të New York Times, Megan Twohey dhe Jodi Kantor, të cilat ekspozuan akuzat për abuzim seksual kundër producentit të famshëm të Hollywood-it, Harvey Weinstein. Kjo histori tronditëse kishte shërbyer si një pikënisje për lëvizjen #MeToo, duke thyer dekada heshtjeje rreth temës së sulmeve dhe ngacmimeve seksuale nga persona me autoritet.

Të rinjtë që ishin pjesë e natës së filmit, diskutuan rreth filmit dhe shprehën shqetësimet e tyre lidhur

me ngacmimet seksuale në Universitet të Prishtinës, por edhe në shoqërinë tonë në përgjithësi.



16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE



Gjatë gjithë fushatës së sivjetme të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Artpolis organizoi gjithsej nëntë aktivitete: *Marshi "Boll Ma: Stop Femicidit"*, *performanca "Hope Bubble"*, *libri komik "Edi, Labirinti Dardan dhe Porta e Tukanës"*, *murali "Nuk jam pronë e askujt. Edhe një shuplakë është dhunë"*, *shfaqja teatrale "Pa Limit"*, *shfaqja forum teatër "Tech-No"*, *performanca "Be Aware: Patriarchy Destroy Zone"*, *protesta "Nuk paqë pa sigurinë e grave"*, *reagimi publik "Femicidi është urgjencë kombëtare"*.

174 artistëve dhe aktivistëve dhe 630 persona në audiencë ishin pjesë e këtyre aktiviteteve të organizuara nga Artpolis. Me rëndësi të veçantë ishte kërkesa për drejtësi për Liridona Ademaj-Murseli, 30-vjeçarja e cila u vra tragjikisht nga bashkëshorti i saj më 29 nëntor, 2023. Kjo ngjarje e rëndë ka ngjallur reagime të shumta, duke bërë që Artpolis të dënojë ashpër këtë akt femicidi së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile.

AKTIVIZMI FEMINIST NË NDËRTIMIN E PAQES



Ndërtimi i paqes dhe mirëmbajtja e tij është një angazhim i përditshëm i Artpolis. Tensionet e vazhdueshme dëshmojnë paqen e brishtë në Ballkan, prandaj secili veprim i yni ka rëndësi jetike në mbajtjen e paqes dhe përmirësimin e marrëdhënieve

ndër-etnike. Më 2023 Artpolis dhe organizatat partnere nga rajoni kanë dhënë kontribut të rëndësishëm përmes shfaqjeve teatrore, punëtorive, ligjëratave, trajnimeve, ekspozitave dhe festivaleve.

SHKOLLA PRANVERORE FEMINISTE



Shkolla Pranverore Feministe (FSS) është realizuar me sukses në Kosovë dhe Serbi nga Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet dhe Qendra Alternative për Vajza/ Krushevc, duke bërë bashkë 34 pjesëmarrëse nga të dy shtetet, të cilat patën rastin të mësojnë mbi ndërtimin e paqes me qasje feministe nga 13 ligjëruese.

Pjesa e parë e FSS-së, që bashkoi 18 vajza, u mbajt në Vërnjačka Banjë të Serbisë më 6-9 prill, 2023. Pjesëmarrëset patën rastin të mësojnë nga aktivistet dhe feministet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina: *Andrijana Kocić, Selena Simić, Jelena Višnjic, Jelisaveta Blagojević, Ajna Jusic, Jadranka Milicevic.*

Përvojat shumëvjeçare dhe me historitë e tyre të aktivizmit arritën të depërtojnë tek pjesëmarrëset, të marrin vëmendjen e tyre dhe t'i përfshijnë në diskutime.

Pjesa e dytë e FSS-së është realizuar më 4-7 nëntor, 2023. Kësaj radhe qyteti i bukur i Prizrenit, me diversitetin e tij kulturor, i mirëpriti 16 aktiviste nga Kosova dhe Serbia në një udhëtim të përbashkët kulturor e feminist.

Temat që u ligjëruan dhe u diskutuan në grup ishin “Bashkëpunimi dhe lëvizja e grave prej viteve të ’90-ta”, “Rimëkëmbja e dinjitetit: Njohja e Statusit të të Mbijetuarave të Dhunës Seksuale në luftën e fundit në Kosovë”, “Thyerja e stereotipeve: Fuqizimi i grave në media dhe demaskimi i lajmeve të rreme”, dokumentari “Biba May – Jo Më – një rrëfim frymëzues për fuqizimin e vajzave me aftësi të kufizuara”, “Siguria e Integruar: Fuqizimi i Grave për Vetëkujdes, Aktivizëm dhe Reflektim në Veprim”, dhe “Thyerja e barrierave: Sfidimi i roleve gjinore në film”.

Aktivistet dhe ligjërueset, të cilat me përvojën e tyre shumëvjeçare në fusha të ndryshme inspiruan dhe motivuan pjesëmarrëset në këtë edicion ishin: Igo Rogova, Lepa Mladenović, Feride Rushiti, Jeta Xharra, Resmije Rahmani, Yllka Soba dhe Elena Avdija. Me fjalime motivuese pjesëmarrëseve iu drejtuan edhe Visare Mujko Nimani nga UNFPA dhe Tamara Smidling nga Fondacioni KtK.

“GRATË TROJANE – REPLIKA”, NË UDHËTIM TË TRAGJEDISË NJERËZORE ME THIRRJE PËR PAQE



“Gratë Trojane – Replika”, më 23 nëntor, 2023 e mori publikun në një udhëtim të tragjedisë njerëzore, nga Troja në ditët e sotme, dhe fatin e grave përmes thirrjes për paqe.

Me regji nga regjisoret feministe Zana Hoxha dhe Dijana Milošević dhe performancë të Ansambleve të Artpolis dhe Dah Teatër prezantimi i “Gratë Trojane – Replika” në bashkëdyzim gjuhësh, shqip dhe serbisht, portretizoi vuajtjet e heshtura të grave pas luftës, duke theksuar cenueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre përballë shtypjeve sistematike.

Ky prezantim, që është në shërbim të krijimit final të shfaqjes, vjen edhe si çortim për “hyjnitë” e sotëm – politikanët. Kritikohet lehtësia mbi të cilën vendosin fatin e popujve, luftërat që shkaktojnë, e pasojat shkatërrimtare të akteve të tyre. Pas përfundimit të prezantimit audienca parashtrroi pyetje të shumta, e pati komente për artistët dhe performancën.

“Realizimi i shfaqjes më pëlqej shumë, ngjall emocion dhe më pëlqej bashkëpunimi mes dy gjuhëve,

diversiteti tregoi se mund të kemi respekt dhe bashkëpunim mes dy shteteve”, u shpreh një vajzë e re në audiencë.

“Ky prezantim dhe bashkëpunim vjen në kohë të duhur marrë parasysh tensionet momentale mes Kosovës dhe Serbisë, ndoshta si shembull që nëse politika krijon tensione, është përdorimi i artit ai që i zbutë tensionet dhe kontribuon në komunikim, bashkëpunim dhe paqe”, tha një tjetër.



PUNËTORIA “LOJA TEATRORE SI NJË METODË PËR TË ANALIZUAR SHOQËRINË”



Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me organizatën Artpolis, kanë organizuar më 13-23 nëntor, 2023 punëtorinë “Loja teatrale si një metodë për të analizuar shoqërinë”, që u udhëhoq nga regjisori dhe dramaturgu i mirënjohur, Zlatko Pakoviq.

Dy të rinj nga Kosova dhe katër nga Serbia për dhjetë ditë patën mundësi të diskutojnë e të mëso-

jnë në fazën e parë rreth të drejtave universale të njeriut, feminizmin dhe patriarkalizmin në Ballkanin Jugperëndimor. Pjesa e dytë iu kushtua punës dramaturgjike, përmes së cilës pjesëmarrësit krijuan skena dramatike bazuar në shembuj nga jeta e përditshme. Kurse në fazën e tretë u përfshie një analizë kritike të materialit të paraqitur dramatik dhe një bashkëbisedim, ndërsa faza e fundit ishte xhirimi i një filmi dokumentar, me pjesëmarrësit në punëtori.

THYERJA E BARRIERAVE NDËRKULTURORE



14 artistë/e të rinj nga Kosova dhe Serbia u bashkuan në udhëtimin e përbashkët për të shkëmbyer përvojat dhe kulturat e dy vendeve dhe për të mësuar më shumë në krijimin e veprave artistike me qëllimin e ndërtimit të paqes.

5 (pesë) ditët e para të aventurës 10 ditore, 27 – 31 maj, 2023 ishin të mbuluara me punëtori, ligjëratat e vizita institucioneve kulturore, në Prishtinë dhe Prizren, kurse pesë ditët e tjera, 1-5 qershor, 2023 u zhvilluan në Beograd e Novi Sad.

Ideatorja dhe mentorja e programit, Tamara Tomaseviq punoi ngushtë me pjesëmarrësit/et e programit duke praktikuar teknika të ndryshme artistike e kulturore, me mbështetje psikologjike për të krijuar hapësirë të sigurt për të gjithë. Përveç saj në këto dhjetë ditë ditë ligjëratat u pasuruan edhe me ndarjen e përvojave dhe njohurive nga Zana Hoxha, More Raça, Bashkim Fazilu, Adea Kondirolli, Shkelzen Gashi, Blerta Hoçia, Veton Nurkollari, Aleksandra Djuric Bosnić, Jelena Bozić, Branislav Dimitrijević, Stevan Filipović, Dijana Milosević, Jadranka Angelić, Sonja Biserko, dhe Lola Joksimović.

KOLONIA ARTISTIKE NË BEOGRAD



Më 11-15 shtator, 2023 u mbajt kolonia e artistëve të programit “Icebreakers”, e organizuar nga Komiteti i Helsinkit në Serbi, dhe Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet (Kosovë).

Artistët e rinj, nga fusha të ndryshme të artit, morën pjesë me projektet e tyre si: ekspozita, krijime të veshjeve, tregime, audio-libra, fotografi dhe video, skulpturë dhe art konceptual. Në përgjithësi kri-

jimet artistike kanë të përfshira detaje të kulturave përkatëse dhe këndvështrime të veçanta ndaj ndasive sipas përkatësisë etnike, që sipas formatit të programit ka për qëllim të përbashkët njohjen dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm të këtyre artistëve.

Kjo koloni artistike është pasuar me ekspozitën e përbashkët në Prishtinë, Beograd dhe Novi Sad.

“KALEIDOSCOPE” NDËRLIDHË RRËFIME PËRTEJ KUFIJVE



Foto: Esad Duraki

Arti dhe të drejtat e njeriut u bashkuan në një prezantim të harmonizuar kur Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi shpalosën ekspozitën “KALEIDOSCOPE”. Duke filluar në Prishtinë më 8 dhjetor 2023, ekspozita vazhdoi rrugëtimin e saj për në Beograd më 10 dhjetor dhe në Novi Sad më 11 dhjetor.

Veprat e ekspozuara të nëntë artistëve të rinj janë rezultat i rrëfimeve personale të ndërthurura dhe herë pas here konfliktuale të individëve që jetojnë në dy kontekste të dallueshme, por gjithsesi të ndërlidhura. Ky është një bashkëpunim jo vetëm në nivel institucional, por më e rëndësishmja, mes njerëzve që duke kapërcyer kufizimet, frikën dhe paragjykimet e mundshme u angazhuan në një dialog.

Yllka Haxhiu, Nevena Deliq, Arilda Bajrami Sadriu, Emnesa Rrukiqi, Marija Mladenović, Butrint Pasha, Leartha Ibraj, Ana Novaković dhe Zana Berisha bashkëpunuan me njëri/a-tjetrin/ën duke sjellë në jetë narrativat e tyre personale, ku takohen e kaluara dhe e ardhmja. Përmes “Kaleidoscope” ata sollën një perspektivë alternative për shoqërinë në Ballkan.

*“Duke qenë pjesë e këtij projekti, kuptova se arritja më e madhe mes nesh, pjesëmarrësve, do të ishte (edhe pse është një klishe) të kuptuarit dhe krenimin e dallimeve tona. Por, ndërsa u njohëm më mirë dhe ndërsa u rritëm së bashku në një farë mënyre, mësova se jo të gjitha dallimet janë aty për t’u festuar. Për shembull, kishte një ndryshim të madh në përvojat tona të jetës midis shoqes sime Arilda dhe unë që thjesht nuk mund ta pranoja. Unë kurrë në jetën time nuk kam pasur një përvojë që të më drejtohet një armë në kokën time, dhe ajo, shoqja ime e dashur e ka kaluar këtë si fëmijë”, **Marija Mladenović** nga Vranja/Serbi, pjesëmarrëse.*

*“Jam artiste nga Drenasi dhe dua të them që e gjithë kjo eksperiencë ka ndryshuar jetën time; më ka bërë të reflektoj nga e kaluara dhe të besoj në fuqinë shëruese të artit. Jam shumë krenare që kam marrë pjesë në këtë program sepse kam takuar disa njerëz të mrekullueshëm që s’do t’i harroj kurrë. Dua të shtoj që nganjëherë duhet të shkosh pikërisht aty ku të gjithë të thonë të mos shkosh. Jam shumë krenare për të gjithë kolegët e mi dhe të gjithë organizatorët. Faleminderit”, **Emnesa Rrukiqi**, pjesëmarrëse.*

FEMART PËR PAQE



Festivali FemArt, që nga themelimi, ka shërbyer si platformë e paqes dhe e ndërtimit të urave të bashkëpunimit. Konceptet si “ne dhe ata” shkrihen, e jeta e tjetrit është po aq e vlefshme sa e jotja, dallimet

janë pasuri e sfidat janë të përbashkëta. Artiste/ë dhe aktiviste/ë nga 16 shtete të ndryshme pasuruan programin e edicionit të 11-të të FemArt.

“KALLE TUTËN: NJË KONFERENCË PËR JETESË TË GUXIMSHME”



Më shumë se 50 artiste/ë dhe aktiviste/ë nga Kosova dhe rajoni morën pjesë në konferencën “Kalle Tutën: Një Konferencë për Jetesë të Guximshme”, që u mbajt në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Ky aktivitet shërbeu si platformë diskutimi për temat si vijojnë më poshtë, të ndara në tre panele diskutimi:

Përmes këtyre diskutimeve, u krijuan rekomandime vepruese të nevojshme për të nxitur ndryshime pozitive, duke krijuar një mjedis më të barabartë dhe gjithëpërfshirës për gratë në pozicionet vendimmarrëse të artit dhe kulturës, dhe ndërtimin e paqes në rajon.

- “Përtej paragjytimeve: “Fuqizimi i grave për të tejkaluar stereotipet në vendimmarrje në art dhe në kulturë”
- “Paqe dhe Siguri: Kapërcimi i Frikës dhe Ndërtimi i Komuniteteve të Qëndrueshme”
- “Thyerja e stigmës: Shëndeti Mendor dhe Mirëqenia në kohë sfiduese”

SHFAQJA TEATRORE “VAJZAT”



Foto: Esad Duraki

Shfaqja “Vajzat” nga Serbia, ishte një rrëfim intim dhe personal që hodhi dritë mbi paragjykimet dhe stereotipet që hasin vajzat e reja gjatë rritjes. Ideja e shfaqjes ishte fuqizimi i grave dhe vajzave për të qenë aleate dhe për të mbështetur njëra-tjetrën, por edhe për t’u dërguar atyre mesazhin se VAJZAT MUND TË BËJNË GJITHÇKA. Që të gjitha vajzat në botë janë të guximshme, të zgjuara dhe se të gjitha meritojnë të rriten në një mjedis të shëndoshë dhe të sigurt.

Dhjetë vajza në këtë shfaqje ekzaminuan kufirin në mes personale dhe politike. Të gjitha ngjarjet që i rrëfyen ishin të vërteta dhe të veçanta, por në të njëjtën kohë ato ishin të përzgjedhura, si karakteristike të një numri të madh vajzash në shoqërinë tonë. Kjo shfaqje ishte: art edhe aktivizëm, sepse “personalja është politike”. Ne folëm për veten, në mënyrë që të kuptojmë botën.

Në Teatrin Dodona mbi 100 persona e shikuan këtë shfaqje.

“Unë besoj fuqishëm se kur njerëzit e njohin njëri-tjetrin, ata nuk mund ta urrejnë njëri-tjetrin. Të gjithë jemi viktimë të manipulimit. Sa herë që ne pretendojmë se Kosova është një vend i frikshëm, bëhet e frikshme, sepse kur i pengon njerëzit të komunikojnë, ata natyrisht kanë frikë nga njëri-tjetri” **Milena Minja Bogavac, regjisore dhe dramaturge e shfaqjes “Vajzat”, në intervistë për Prishtina Insight.**

“Njerëzit priren të gjykojnë më pak kur e kuptojnë më mirë njëri-tjetrin. Prandaj, ne përpiqemi t’i bashkojmë njerëzit duke i informuar dhe ekspozuar ndaj artit apo artit kryesisht feminist që trajton çështjet e të drejtave të njeriut. Më pas është zgjedhja e tyre nëse duan të ndryshojnë mentalitetin e tyre”, **Zana Hoxha, drejtore ekzekutive e Artpolis, në intervistë për Prishtina Insight.**

ALUMNI NETWORK



Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet në bashkëpunim me Alternative Girls Center nga Serbia e kanë themeluar Alumni Network në kuadër të Shkollës Pranverore Feministe.

Takimi i parë i Bordit të Alumnit është mbajtur në dhjetor, 2023 i cili do të shërbejë që vajzat pjesëmarrëse ndër vite në Shkollën Pranverore Feministe të fuqizohen edhe më shumë, duke ndër-tuar ura të paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

PROJEKTI TRANSNACIONAL UNMASC!



Artpolis ka nisur edhe një partneritet të ri dhe të rëndësishëm në thyerjen e barrierave transnacionale, në partneritet me Kulturanova nga Novi Sadi i Serbisë dhe Kulturhaus Broatfabrik nga Vjena e Austrisë.

Ky bashkëpunim ka nisur në dhjetorin e vitit 2023 në kuadër të projektit të ri të Creative Europe “UNMASC! Promovimi i Drejtësisë Gjinore përmes Teatrit”.

UNMASC! është një projekt dyvjeçar i kërkimit dhe teatrit artistik transnacional në Kosovë, Serbi dhe Austri që synon të promovojë drejtësinë gjinore duke e bërë të dukshme dhunën strukturore dhe duke krijuar kundër-narrativa ndaj vlerave, normave dhe pritshmërive të roleve mizogjeniste dhe patriarkale.

FUQIZIMI I TË RINJVE DHE TË REJAVE



Në qendër të misionit të Artpolis, përveç aktivizmit artistik, është përkushtimi për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve dhe të rejave. Transmetimi i njohurive të ta dhe krijimi i një hapësire të sigurt për t'u shprehur, krijuar e fuqizuar janë thelbësore për

të sjellë ndryshimet pozitive në shoqëri. Përmes trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve artistike të organizuara nga Artpolis nxisim entuziazmin, rrisim përkushtimin e disiplinën për të inspiruar të rinjtë në rrugëtimin e tyre jetësor.

ÇIKAT E SJELLSHME



Më 2023 Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis ka fuqizuar, inspiruar e motivuar 75 vajza dhe gra përmes kursit të vetëmbrojtjes “Çikat e Sjellshme”.

Të mentoruara nga mjeshtri i Taekwondo-së, Nuhi Gashi, në Akademinë e Arteve Marciale Prishtina, këto vajza kanë mësuar teknika të ndryshme të vetëmbrojtjes, duke rritur kështu vetëbesimin, sigurinë e tyre, dhe njohuritë rreth veprimeve në rast të sulmeve fizike ndaj tyre.

Dhjetë prej tyre kanë ndjekur nivelin e Trajnimit për Trajnere, duke u fuqizuar edhe më tepër nga niveli bazik. Të gjitha ato janë certifikuar për ndjekjen e këtij kursi të vetëmbrojtjes.



EDUKIMI I GRAVE TË REJA MBI FEMINIZMIN



Sa më herët kuptimësojmë të drejtat tona, aq më herët i japim fund shtypjeve dhe pabarazive – aq më afër lirisë dhe realizimit të ëndrrave jemi. Prandaj, Artpolis më 2023 ka realizuar 10 trajnime të feminizmit në tetë qytete të Kosovës, me 164 vajza e gra pjesëmarrëse të etnive dhe moshave të ndryshme, përfshirë edhe 35 me aftësi të kufizuara.

Këto trajnime janë mbajtur në Prishtinë, Obiliq, Malishevë, Klinë, Kamenicë, Prizren, Suharekë, Mitrovicë nën ligjërimit të aktivistes dhe feministes, Liridona Osmanaj.

Ajo ka inspiruar pjesëmarrëset duke ligjëruar mbi definicionet e feminizmit, historinë e lëvizjeve

feministe në botë, si dhe zhvillimin e feminizmit në Kosovë dhe mundësinë që të kontribuojnë në aktivitete të ndryshme.



KLUBET TEATRORE DHE TRAJNIMI EDUKIMI I BAZUAR NË TEATËR



Teatri është një nga mjetet më të rëndësishme të Artpolis në nxitjen e krijimtarisë artistike, aktivizmit feminist dhe fuqizimit të të rinjve dhe të reja.

Më 2023 Artpolis ka themeluar 5 Klube Teatrore (dy prej tyre me persona me aftësi të kufizuar), me 92 të rinj dhe të reja pjesë e tyre. Nën mentorimin e Ansambllit të Artpolis këta të rinj kanë dhënë pesë shfaqje premierë, tetë në total së bashku me repri-za, të ndjekur nga 770 persona në audiencë.

Ansambli i Artpolis gjithashtu ka drejtuar dy trajnime “Edukimi i Bazuar në Teatër”, duke i mentoruar 36 të rinj dhe të reja nga komunitete të ndryshme.

Klubet janë themeluar në:

- Klubi Teator në Prishtinë (Handikos) / 21.02 – 04.07.2023 / Pjesëmarrës: 27
- Klubi Teator në Obiliq / 23.02 – 14.06.2023 / Pjesëmarrës: 27
- Klubi Teator në Drenas / 04.04 – 13.06.2023 / Pjesëmarrës: 15
- Klubi Teator në Klinë / 06.10 – 08.12.2023 / Pjesëmarrës: 8
- Klubi Teator në Prizren (Me Down Syndrome Kosova) / 26.10 – 15.12.2023 / Pjesëmarrës: 15

SHFAQJET FORUM TEATËR DHE PERFORMANCAT

Me gjasht premiera dhe 11 repriza ky vit shënoi një angazhim të jashtëzakonshëm të stafit dhe Ansambilit të Artpolis në fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të të rinjve përmes teatrit.

Të rinjtë dhe të rejat pjesëmarrës në Klubet Teatrore patën mundësi të zgjedhin dhe të trajtojnë tema sociale nga më të ndryshimet, që nga bullizmi kibernetik e deri tek dhuna në familje e në shkolla dhe përkujdesi i personave me aftësi të kufizuara.

“PA LIMIT”, PËR KREATIVITETIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Më 04 korrik, 2023 u mbajt premiera e **shfaqjes “Pa Limit”**, me aktore/ë që i përkasin grupit të personave me aftësi të veçanta. Me thjeshtësi dhe guxim ata/ato sollën ngjarje nga jeta e tyre, duke ju dhënë emocione të shumta publikut me prezantimin e tyre kreativ të organizuar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Artpolis dhe Handikos.

“Pa Limit” prezantoi një ditë pushimi të përbashkët në bregdet, ku të gjithë ndihmojnë njëri-tjetrin dhe krijojnë kujtime të paharrueshme. Me mesazhin që personat me nevoja të veçanta mund të punojnë, të krijojnë vepra artistike dhe të jetojnë të pavarur, kjo shfaqje u mirëprit edhe me dy prezantime në Mitrovicë (28.09.2023) dhe një prezantim në Vushtrri (04.12.2023). Pas shfaqjeve, para **420 personave në audiencë**, aktorët nuk u kursyen të shfaqin edhe më tutje talentet e tyre në poezi, këngë, piktura, si dhe punimet nga argjila e druri.

Pjesë e shfaqjes dhe ekspozitës ishin: Fahri Krasniqi, Afërdita Haxholli, Albin Salihi, Festina Ibishi, Trimor Idrizi, Fortesë Vishesella, dhe Blerina Krasniqi, që u mentoruan nga Ansambli i Artpolis: Edlir Gashi, Kaltrinë Zeneli dhe Robert Nuha.

*“Unë kam pas shumë marre, edhe nuk kam repovat para publikut. Ky projekti ma ka plotësuar ëndrrën, që unë të bëj këngë. Realiteti ka qenë i hidhur, por dikush ka dalë që më ka kuptuar dhe për këtë jam falënderues”, **Albin Salihi, pjesëmarrës në Klubin Teatror të Prishtinës.***

*“Këta njerëz mund t’i quajmë dashni, shpirtë, këta janë vetë jeta, këta janë inspirim për mua dhe për krejt shoqërinë. Unë kam pasur shumë shfaqje me aktorë jo profesionistë, kjo mundet me qenë e 13-ta apo e 14-ta, por kjo ka qenë përvoja ma e veçantë në jetën time, ma e veçantë sepse këta më kanë bërë ta kuptoj që jeta nuk është diçka e thjeshtë”, **Edlir Gashi, mentor i Klubit Teatror Prishtinë.***

*“Kjo shfaqje është një bashkëpunim, ku rolin kryesor e kanë anëtarët e Handikos me aftësi të kufizuara në bashkëpunim dhe me mbështetje të organizatës Artpolis. Gjatë provave ata zhvilluan më shumë aftësitë e tyre komunikuese, gjithashtu mësuam më mirë gjuhën e trupit, si t’i përdorin lëvizjet, gjithashtu edhe talentet e tjera që ne që kemi punuar direkt me ta nuk i kemi ditur, si për shembull në krijimin e poezive, intonacionin e zërit, gjithashtu edhe aftësitë e tjera komunikuese”, **Arta Sejdiu nga Handikos.***

TË RINJTË/REJAT E OBILIQIT ME SHFAQJE KUNDËR DHUNËS



Klubi Teator në Obiliq ka prezantuar më 14 qershor **shfaqjen forum teatër “Zilja kundër dhunës”** në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” në prezencën e rreth **400 personave në audiencë.**

Shfaqja “Zilja kundër dhunës” trajtoi një temë tejet sensitive dhe shqetësuese, atë të dhunës në shkolla ndërmjet nxënësve. Shfaqja vuri në pah një refleksim analitik të gjendjes së tanishme dhe situatës në shkollat tona, e cila fatkeqësisht është tejet problematike. Pas performancës audiencia pati mundësi të diskutojë me personazhet rreth temës së trajtuar në shfaqje.

Në këtë shfaqje luajtën të rinjtë dhe të rejtat nga Obiliq: Almira Mehana, Ari Saraqi, Elvira Grajçevci, Elma

Preniqi, Endrit Prokshi, Rea Xhakalija, Zyla Maloku, Ajana Kicaj, dhe Sara Krasniqi, të cilët janë mentoruar nga Ansambli i Artpolis: Shpëtim Selmani, Mikel Markaj dhe Robert Nuha.



SHFAQJA “HAMLET / HIGH – M’LE T / HI! – M’LE TË...” ME THIRRJE KUNDËR DHUNËS



Më 13 qershor, në Shtëpinë e Kulturës në Drenas është prezantuar **shfaqja forum teatër “Hamlet / High – m’Le T / Hi! – m’le të...”**. Të rinjtë dhe të rejat nga Drenasi përmes kësaj shfaqje kanë bërë thirrje për ndalimin e dhunës fizike e psiqike ndaj fëmijëve, dhe mbështetje për fëmijët që mund të jenë viktime të dhunës.

Pas shfaqjes rreth **100 persona në audiencë** patën rastin të diskutojnë me personazhet mbi temën e trajtuar, duke theksuar rëndësinë që ka edukimi pa dhunë, e dashuria për fëmijët.

Në këtë shfaqje luajtën Getuar Krasniqi, Amrush Istogu, Eduarta Kukaj, Aurela Hajdari, Gerti Karaqica, Edonis Fana, Vesa Buzaku, Andi Dervishi, Verora

Gashi, Argjend Karaqica, dhe Enes Desku, të cilët janë mentoruar nga Ansambli i Artpolis: Donikë Ahmeti, Zhaneta Xhemajli dhe Robert Nuha.



“GJITHÇKA”, PËR NORMAT E MBIVENDOSURA PËR NËNAT VETUSHQYESE



Më 26 qershor, 2023, në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhevdet Doda” u prezantua **shfaqja forum teatër “Gjithçka”**.

“Gjithçka” erdhi si një rrëfim skenik që shfaq përvojat e grave e veçanërisht grave vetëushqyese në shoqërinë tonë dhe pritshmëritë e vendosura për to për të përmbushur role të shumta në të njëjtën kohë. Shfaqja eksploron presionet shoqërore dhe përballjen e fëmijëve me sfidat që vijnë si rezultat i këtij realiteti.

Të rinjtë përmes shfaqjes frymëzuan publikun për të njohur dhe trajtuar këto çështje, të sfidojë normat shoqërore dhe për të nxitur një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë për të gjithë.

Një debat i gjerë, aktiv dhe i thellë u realizua ndërmjet publikut dhe personazheve duke përçuar me-

sazhin se dhuna nuk duhet të tolerohet, e shtypja ndaj grave duhet të marrë fund.

Kjo shfaqje pati edhe dy prezantime të tjera në Prishtinë dhe Gjilan, duke u prezantuar para **143 personave në audiencë** në tri prezantime. “Gjithçka” u krijua nën mentorimin e aktorese dhe aktorit të Ansambllit të Artpolis, Qëndresa Kajtazi dhe Edlir Gashi.



“TECH-NO” ME MESAZHE RRETH NDIKIMEVE NEGATIVE TË TEKNOLOGJISË



Më 8 dhjetor, 2023 Klubi Teator në Klinë ka prezantuar **shfaqjen forum teatër “Tech-no”**, në Shtëpinë e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”.

Përmes kësaj shfaqje të rinjtë dhe të rejtat e përfshirë në këtë klub teator kanë shpërfaqur varshmërinë e të rinjve nga teknologjia, ndikimit negativ të përdorimit të shumtë të telefonit, që shpesh herë na qon në cenimin e privatësisë. “Tech-no” ishte një thirrje nga këta të rinj që të ndalet bullizmi kibernetik, e keqpërdorimi i telefonave nga ana e nxënësve në shkolla.

E prezantuar para më shumë se **200 personave në audiencë**, kjo shfaqje nxiti debat edhe me audiencën që parashtruan pyetje të shumta për personazhet, duke vënë në pah problemet e shumta që vijnë nga teknologjia.

Procesi krijues në klubin teator për këta të rinj, përveç njohurive mbi teatrin ka shërbyer edhe si rritje vetëbesimit dhe tejkallim të frikës për t’u përballur publikun.

Në këtë shfaqje luajtën: Aurela Gashi, Aulona Smajli, Alena Gashi, Blediona Manaj, Brenda Gojani, Ergi Limanaj, Eronita Gashi, dhe Farie Gashi. Këta të rinj dhe të reja u mentoruan dhe u përgatitën nga Ansambli i Artpolis: Shpëtim Selmani, Qendresa Kajtazi, dhe Labinot Raci.

*“Bashkëpunimi me Artpolis ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme dhe na ka ndihmuar shumë në rritjen e vetëbesimit, dhe na ka mësuar shumë për botën e teatrit dhe procesin e krijimit të shfaqjes”, **Ergi Limanaj, pjesëmarrës në Klubin Teator në Klinë.***

*“Sot e përfunduar me sukses shfaqjen “Tech-no”. Me të vërtetë është bukur kur merresh me aktivitete e sidomos me aktrim. Organizata Artpolis na ka ndihmuar që të kemi më shumë vetëbesim, të jemi më të hapur para publikut. I falënderoj shumë që na mundësuan të realizojmë këtë shfaqje”, **Aulona Smajli, pjesëmarrëse në Klubin Teator në Klinë***

“TRISOMY LOVE”, PËR DASHURINË DHE FUQIZIMIN I PERSONAVE ME DOWN SYNDROME



Më 15 dhjetor, 2023 persona me sindromë Down kanë luajtur në performancën “Trisomy Love” në Qendrën Kulturore Rinore në Ortakoll, Prizren.

Organizuar nga Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, në bashkëpunim me Down Syndrome Kosova – Qendra Prizren, performanca “Trisomy Love” ishte një manifestim i dashurisë së personave me sindromë Down dhe përditshmërisë së tyre.

Me vallëzime të ndryshme dhe recitime Ada Gorda, Arlind Rizanaj, Alber Bytyqi, Aela Qaflehi, Behije Arapi, Diana Gashi, Flamur Bytyqi, Fatmir Sallah, Liridona Xhemaj, Merlinda Sope, Ndalore Likaj, Se-

lim Maloku, dhe Smajl Hoti dhanë një performancë shumë emocionale për të gjithë të pranishmit në sallë. Ata/ato u mentoruan nga aktoret e Ansambllit të Artpolis: Donikë Ahmeti dhe Blerta Gubetini.

Përtej sipërfaqësore, përtej asaj çka shohim ne, zbulohen shtresa të emocioneve dhe reagimeve të personave me sindromë Down. Ne afrohemi deri tek njohja e vërtetë e dashurisë që këta persona kanë për të dhuruar çdo ditë përkundër vështirësive të tyre për jetë që janë të dyfishuara. Fuqia më e madhe e tyre është ajo të cilën nuk mund ta shohim. Ajo është brenda tyre dhe ata e manifestojnë tek ne si ndjesi.



“Anëtarët e Shoqatës tonë, që kanë qenë artistët e kësaj shfaqje, i kanë shijuar tejmasë këto prova intensive ku kanë pasur mundësinë me i shfaq emocionet dhe talentin e tyre pa asnjë barrierë dhe pa ju vendosur asnjë kufi. Kjo ka qenë një mundësi shumë e mirë për secilin prej anëtarëve tonë për me e shfaq veten e tyre përball një publiku të gjerë. Në këtë proces anëtarët tanë kanë ardhur me shumë qejf dhe kanë pasur shumë energji pozitive, dhe përveç neve si staf që e kemi vërejtur, kanë qenë edhe reagimet e prindërve që na kanë dhënë komente, të cilët kanë thënë se është rritur liria e shprehjes, lirinë që ata me bo gjithçka që kanë dashur, të kërcejnë e të vallëzojnë së bashku dhe me i shpreh ndjenjat e tyre në pjesë teatrale”, ka thënë **Grenita Grazhda, punëtore sociale në Down Syndrome Kosova – Qendra Prizren.**

“Shfaqja ka qenë shumë e mirë, jemi kënaqur shumë. Kemi kaluar shumë mirë me të gjithë kolegët. Donika e Blerta shumë të mira, i kam këtu në zemër, krejt i kam në zemër”, **Selim Maloku, pjesëmarrës në Klubin Teatror në Prizren.**

“Të punoj me personat me sindromë Down këtë periudhë për mua ka qenë një “sfidë” e ëmbël. T’i shohësh vështirësitë e tyre, specifikat e mënyrës

së jetesës dhe përpjekja për t’i kuptuar e pastaj përmes artit t’i shndërron në teatër ishte një mësim për mua për të cilin nuk e dija se kam nevojë ta përjetoj. Këta persona, me dashurinë që kanë brenda tyre meritojnë thirrje edhe për më shumë hapësira dhe njerëz që kanë mjaftueshëm vullnet ta vënë në pah këtë dashuri, për të cilën unë e ndjej veten me fat dhe krenare që së bashku me Donikën dhe Artpolisin e kemi bërë këtë. Dua të falënderoj edhe Down Syndrome Kosova këtu në Prizren për një bashkëpunim shumë korrekt dhe të palodhshëm. Angazhimi i tyre në procesin krijues na ka lehtësuar punën dhe na ka ndihmuar të kuptojmë sa më mirë të gjithë pjesëmarrësit. Pa këtë bashkëpunim të ngushtë kjo performancë që e pamë sot vështirë se do ta kishte këtë rezultat”, **Blerta Gubetini, aktore e Ansambllit të Artpolis dhe mentore në Klubin Teatror në Prizren.**

“Shfaqja ka qenë shumë e mirë, edhe procesi shumë i mirë. Dua të ju falënderoj të gjithëve që jeni angazhuar për ta bërë të mundur këtë shfaqje. Ada ka kaluar shumë mirë dhe ka qenë shumë e lumtur gjatë gjithë këtij procesi. Personat me sindromë Down duhet t’i angazhohjmë sa më shumë në aktivitete artistike”, **Nurten Gorda, nëna e Ada Gorda që luajti në performancën “Trisomy Love”.**

FUQIZIMI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Gjithëpërfshirja dhe diversiteti janë dy nga karakteristikat që e bëjnë të veçantë punën e Artpolis, prandaj ky angazhim është rritur më 2023 në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara.

Përmes shfaqjeve, dokumentareve, klubeve teatrore e formave të tjera Artpolis është angazhuar t'u japë zë nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

MES EMOCIONESH “BIBA MAY – JO MË” INSPIRON PËR JETËN



Prezantimi i dokumentarit “Biba May – Jo Më” në Kino Lumbardhi në Prizren, më 15 tetor, 2023 solli emocione të shumta, lotë e të qeshura, por mbi të gjitha inspiroi të pranishmit për të mos u dorëzuar kurrë përballë sfidave. Ky prezantim ishte i veçantë dhe shumë emocionues edhe për vet Bibën që jeton dhe vepron në këtë qytet.

Ky film dokumentar solli rrëfimin e jashtëzakonshëm të Resmije Rahmanit, e njohur si Biba, një grua që sfidon kufizimet e vendosura nga distrofia muskulare dhe shfaqet si një fener shprese dhe frymëzimi. Me një përzierje të rrëfimeve të tregimeve dhe emocioneve të papërpunuara, ky film portretizoi qëndresën e patundur të Bibës, jo vetëm për të mbijetuar, por edhe për të shqyrtuar një këndvështrim të sfidave.

Përmes intervistave intime, kinematografisë mahnitëse dhe një portretizimi emocionues, ne hulumtojmë thellë në botën e saj, duke dëshmuar sfidat e përditshme me të cilat ajo përballet me ven-

dosmëri të palëkundur. Gëzimi i saj i shkëlqyeshëm, momentet e saj të dobësisë dhe optimizmi i saj i pashuar ka prekur zemrat e të pranishmëve në Kino Lumbardhi, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në shpirtin e tyre.

Dokumentari u pasua me një diskutim të gjallë dhe ndarjen e përvojave inspiruese ndërmjet audiencës dhe panelisteve në përbërje të Biba May, Shqipe Malushit, Pranvera Musaj dhe Zana Hoxha.

“Biba May – Jo Më” është një ode për guximin, një festim i durimit dhe një kujtim që asnjë pengesë nuk është e pakapërcyeshme kur shpirti shndritë.

Ky dokumentar ka pasur katër prezantime në total para **171 personave në audiencë**, përfshirë edhe ato në Mitrovicë në kuadër të Festivalit FemArt, në Gjakovë, si dhe në Prizren në kuadër të Shkollës Pranverore Feministe.

Në panelet e tjera të diskutimit ishin edhe: Arlinda Morina, Butrint Pasha, Islam Kasumi, Merita Voca.

QASJA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Gjithëpërfshirja është një nga vlerat më të rëndësishme të Festivalit FemArt, dhe secili hap drejt fuqizimit të grupeve të marginalizuara na dërgon një hap më afër barazisë. Prandaj në edicionin e 11-të programi i FemArt ishte printuar edhe në **alfabet të Brajrit**, dedikuar për persona të verbër në Kosovë. Kjo është arritur edhe falë iniciativës së asistentes së projekteve në Artpolis, Mimosë Musliu, e cila gjithashtu krijoi një **Doracak Udhëzues** për qasjen e personave me aftësi të kufizuar në institucionet kulturore.

Poashtu, në ditën e 3-të të festivalit stafi i FemArt ndërtoi një rampë për karroca në hyrje të objektit të organizatës 7 Art në Mitrovicë, duke u dhënë qasje të gjithë personave përdorues të karrocës për të shikuar dokumentarin “Biba May – Jo Më” dhe për t’u argëtuar në koncertin e Soli Kapadias.

TEATRI SI MJET PËR FUQIZIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Më 2023 Artpolis ka themeluar dy Klube Teatrore me persona me aftësi të kufizuar; me Shoqatën Handikos në Prishtinë dhe me Qendrën e Down Syndrome Kosova në Prizren.

Klubi Teator Handikos me sukses ka krijuar dhe ka prezantuar shfaqjen “Pa Limit”, kurse Klubi Teator në Prizren ka krijuar dhe prezantuar shfaqjen “Trisomy Love”.



RRITJA DHE NGRITJA E KAPACITETEVE TË ARTPOLIS

Krahas realizimit të aktiviteteve dhe fuqizimit të grupeve të marginalizuara Artpolis në vazhdimësi punon në ngritjen e kapaciteteve të veta, përmes organizimit të punëtorive e trajnimeve, si individuale, ashtu edhe grupe për stafin dhe Ansamblin e angazhuar në organizatë.

PUNËTORIA “NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT DHE ANSAMBLIT TË ARTPOLIS”



Më 01-03 shkurt, 2023 në Durrës është mbajtur punëtorja për ngritjen e kapaciteteve të Stafit dhe Ansambllit të Artpolis.

Punëtorja u hap me hartimin e Planit të Punës për vitin 2023, dhe ndarjen specifike të aktiviteteve. Në ditën e dytë të punëtorisë ka zënë vend diskutimi mbi Strategjinë e re të Artpolis 2023-2027, si dhe prezantimi i web faqes së re të Artpolis. Në diskutim me stafin dhe Ansambllin Artpolis është bërë një reflektim mbi strategjinë e kaluar dhe janë finalizuar ndryshimet për Strategjinë e re për pesë vitet e ar-

hshme, gjithashtu stafit dhe trupës iu dha mundësia të japin ide tjera rreth përmirësimit të web faqes së Artpolis.

Pas prezantimit të Strategjisë, diskutimi vazhdoi për organizimin e edicionit të 11-të të Festivalit FemArt. Punëtorja “Ngritja e kapaciteteve të Stafit dhe Trupës Artistike të Artpolis” është mbyllur me diskutim rreth Monografisë së Festivalit FemArt. Udhëhequr nga Ivana Bilic u punua në draftimin e një plani konkret të përgatitjes së Monografisë për 10 edicione të Festivalit FemArt.

STAFI DHE ANSAMBLI I ARTPOLIS VLERËSOJNË FEMART 11



Një muaj pas përfundimit të edicionit të 11-të të Festivalit FemArt stafi dhe Ansambli i Artpolis u mblodhën për të vlerësuar dhe reflektuar për këtë edicion.

Më 15 qershor, 2023 në Gërmi përveç vlerësimit të edicionit që lamë pas, u diskutua gjerësisht edhe për edicionin e ardhshëm. Gjërat që duhet përmirësuar, ato që duhet ruajtur dhe mënyrat që duhet ndjekur për të rritur edhe më shumë kualitetin e aktiviteteve, si dhe ndikimin e Festivalit FemArt në komunitet më 2024.

PUNËTORIA “FUQIZIMI I ORGANIZATËS: NAVIGIMI I MBINGARKESËS SË PUNËS DHE NXITJA E MIRËQENIES”



Më 26-28 gusht, 2023 në Bogë të Pejës stafi dhe Ansambli i Artpolis kanë mbajtur me sukses punëtorinë “Fuqizimi i Organizatës: Navigimi i mbingarkesës së punës dhe nxitja e mirëqenies së stafit, Teoria e Ndryshimit dhe raportimi efektiv”.

Këtë punëtori e udhëhoqi trajnerja Yllka Soba, e cila së bashku me stafin dhe Ansamblin e Artpolis diskutuan për mbingarkesën në punë, dhe format që duhet ndjekur për të rritur mirëqenien e stafit dhe

Ansamblit. Përveç ushtrimeve të ndryshme fizike dhe meditimeve, ekipa e Artpolis pati rastin të ndajnë me njëri-tjetrin teknika të ndryshme të frymëmarrjes, dhe format që ndjekin secili nga ta në përkujdesjen e mirëqenies së tyre.

Poashtu, gjatë kësaj punëtorie tre ditore u diskutua edhe për Teorinë e Ndryshimit, hapat që duhet të ndërmerren për të arritur realizimin e strategjisë së organizatës.

FUQIZIMI I STAFIT



Përveç trajnimeve dhe punëtorive të përbashkëta stafi i Artpolis përgjatë vitit 2023 ka ndjekur trajnime, punëtori, konferenca e ligjërata të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të ndryshme.

Ndër to që vlen të theksohen janë: “IETM Green School”, “Team Building me Granit Tërnavën”, “Konferenca mbi Paqen Feministe”, “Trajnimi për ngritjen e fondeve nga KCSF”, “Trajnimi për Siguri Kibernetike”, “Power to HR”, “Konferenca e Kontabilitetit Dixhital” etj.

KUVENDI I PARË I ANËTARËSISË SË ARTPOLIS



Më 7 tetor, 2023 Artpolis ka mbajtur Kuvendin e Anëtarësisë në Prishtinë.

Kuvendi ishte një mundësi e jashtëzakonshme për t'u lidhur me anëtarët e tjerë të komunitetit, artiste/ë dhe aktiviste/ë, dhe për të mësuar mbi angazhimin e aktivizmit artistik të Artpolis. Poashtu, ky takim i anëtarësisë shërbeu për të shkëmbyer përvoja e ide si të ecim përpara dhe të rrisim aktivizmin feminist përmes artit.

Themeluesja dhe Drejtorja ekzekutive e Artpolis, Zana Hoxha, e cila nuk ishte prezent fizikisht në këtë ngjarje, iu drejtua pjesëmarrësve me një letër falënderimi duke theksuar rëndësinë e angazhimit të përbashkët drejt barazisë sociale.

“Feminizmi është udhërrëfyese i punës së Artpolis, besimi në barazinë gjinore drejton misionin tonë. E

arti është instrumenti ynë për ndryshim, duke sfiduar normat dhe duke avokuar për një botë ku çdo individ, pavarësisht nga gjinia, është i barabartë dhe ka mundësi të barabarta. Ndërsa jemi këtu, le të meditojmë për udhëtimin që na ka bashkuar. Me kalimin e viteve, Artpolis është rritur në një forcë dinamike, falë përpjekjeve kolektive të anëtarëve tanë. Entuziazmi, kreativiteti dhe mbështetja juaj e palëkundur kanë qenë forca shtytëse e sukseseve tona. Sot, festojmë arritjet e Artpolis dhe jemi të vetëdijshëm që ka sfida përpara, por gjithashtu e dimë se forca dhe vendosmëria jonë kolektive mund të kapërcejnë çdo pengesë”, ka thënë Hoxha.

Anëtarësia e Artpolis më 2023 ka shënuar rritje, duke shkuar në **90 anëtare/ë (60 gra dhe 30 burra)**.

VIZITAT DHE BASHKËPUNIMET

Artpolis ka vazhduar edhe këtë vit me ndarjen e përvojave me persona të jashtëm, organizata artistike, studente/ë vendorë e ndërkombëtarë, partnerë e donatorë duke i pritur në zyret e saj apo edhe në hapësira të tjera.

Disa nga vizitat që Artpolis mirëpriti përgjatë vitit 2023 ishin:

STUDENTËT E UNIVERSITETIT TË VENECIAS VIZITUAN ARTPOLIS



Studentë/e nga Venecia vizituan zyrën e Artpolis të shtunën, më 21 janar, 2023. Drejtoresha ekzekutive dhe themeluesja e Artpolis dhe Festivalit FemArt,

Zana Hoxha mirëpriti studentët dhe i njoftoi më shumë rreth aktivizmit artistik të Qendrës për Art dhe Komunitet – Artpolis dhe Festivalit FemArt.

STUDENTË NGA MITROVICA DHE MITROVICA VERIORE VIZITUAN ARTPOLIS



Studentë nga Mitrovica dhe Mitrovica Veriore vizituan Artpolis të shtunën, më 28 janar 2023. Përfaqësueset e Artpolis, Venera Ismaili dhe Valëza Sijarina biseduan me studentët dhe i informuan ata më

shumë për aktivitetet e Artpolis dhe mundësitë e tyre për pjesëmarrje. Fokus kryesor i takimit ishte angazhimi i Artpolis për paqe, si dhe aktivizmi feminist dhe shfaqjet profesionale.

KFOR-I ITALIAN VIZITON QENDRËN ARTPOLIS



Pjesëtarë të Njësitit për Monitorim dhe Vëzhgim – K8 të KFOR-it italian (KFOR LMT – K8) vizituan më 2 mars, 2023 Qendrën për Art dhe Komunitet – Artpolis. Në këtë takim njoftues për aktivitetet e Qendrës Artpolis, ata/ato u pritën nga menaxheret e projekteve në Artpolis, Venera Ismaili dhe Nertila Qarri-Gërguri. KFOR-i italian shprehu interesim për akti-

vitetet, metodën e punës e temat me të cilat merret Qendra Artpolis, si: fuqizimi i grave, ndërtimi i paqes, adresimi i ngacmimeve seksuale, trajnimet me të rinj/reja, shfaqjet teatrale, përkrahja e artistëve/artistëve dhe aktivistëve/aktivisteve si dhe përdorimin e artit dhe kulturës si mjete që përdoren për ndryshim shoqëror.

DELEGACIONI NGA TEATRI ONDA VIZITON ARTPOLISIN



Me datë 18 prill, 2023 në Artpolis për vizitë ishte një delegacion artistësh, shpërndarës e promovues në botë të veprave të artit bashkëkohor skenik, delegacioni nga teatri ONDA – Francë. Delegacioni artistik francez u mirëprit nga drejtoresha ekzekutive e Art-

polis, Zana Hoxha dhe Ansambli i Artpolis, të cilët delegacionin mysafir e informuan detajisht për aktivizmin artistik të organizatës, me theks të veçantë në krijimin e shfaqjeve teatrore.

ZYRTARË TË PEACEBUILDING FUND VIZITOJNË ARTPOLISIN



Më 25.04.2023 Artpolis ishte nikoqire e ekipit nga zyra rajonale e projektit të PeaceBuilding Fund. Drejtorja ekzekutive Zana Hoxha se bashku me stafin dhe Ansambli i Artpolis, prezantuan punën, të arriturat, sfidat dhe sukseset e organizatës. Arti, kultura e në veçanti teatri ishin tema që me shumë interesim u

përcjell nga vizitorët, por edhe u diskutua me pasion nga stafi dhe artistët, të cilët sqaruan punën e tyre në teren me të rinjtë ku përmes trajnimit Edukimi i Bazuar në Teatër fuqizojnë dhe i ndërgjegjësojnë pjesëmarrësit/et për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, ndërtimin e paqes, etj.

STUDENTË NGA AMSTERDAMI VIZITONË ARTPOLISIN

Më 15 qershor, rreth 25 studentë nga Kolegji Universitar i Amsterdimit (AUC), të udhëhequr nga profesoresha Anne de Graaf vizituan zyret e Artpolis,

me ç'rast janë pritur nga drejtoresha ekzekutive dhe themeluesja e Artpolis dhe Festivalit FemArt, Zana Hoxha.

PËRFAQËSUESET E CFD-SË VIZITONË ARTPOLISIN

Më 20 tetor, 2023 stafi i Artpolis, udhëhequr nga drejtorja ekzekutive Zana Hoxha, ka pritur përfaqësueset e organizatës partnere cfd, Lea Breitner dhe Antigona Dajakaj. Përveç diskutimeve për punën e Artpolis, vlerësimin të projektit 2021-2023, në këtë

takim është diskutuar edhe për hapat e ardhshëm të bashkëpunimit dhe rritjes së kapaciteteve të Artpolis dhe rritjes së angazhimit të përbashkët për barazi gjinore e sociale.

KONFERENCA “TEATRI SI MJET PËR NDRYSHIM NË SHOQËRI” NË PRIZREN FEST



Foto: Esad Duraki

Artpolis ka vazhduar bashkëpunimin edhe sivjet me Festivalin “PrizrenFest” duke organizuar konferencën “Teatri si mjet për ndryshim në shoqëri”.

Kjo konferencë u mbajt më 26 korrik, 2023, në ambientet e Shtëpisë së Shani Efendisë, në kuadër të

Festivalit të Teatrit në Ambient të Hapur “PrizrenFest”, dhe morën pjesë artistë të dëshmuar të fushës dhe të moshave të ndryshme, për t’i bërë shumë të afërta për të pranishmit, përvojat që lidheshin me të kaluarën e tyre që ndërlidheshin me tematikën e konferencës.

BLLOGJET

Për të pasqyruar aktivitetet e edicionit të 11-të të Festivalit FemArt janë përkujdesur Ivana Bili Bilić, Romain Taunais, Mimoza Musliu, Johanna Mertinz dhe Shqipe Malushi me blogjet e tyre:

Nga Ivana Bilić

KALLE TUTËN / HAPJA E EDICIONIT TË 11-TË TË FESTIVALIT FEMART <https://femart-ks.com/sq/kalle-tuten-hapja-e-edicionit-te-11-te-festivalit-femart/>

STORJE RRETH CENSURËS, FEMICIDIT DHE LUFTIMIT ME DEMONËT <https://femart-ks.com/sq/storje-rreth-censures-femicidit-dhe-luftimit-me-demonet/>

FESTIVALI FEMART NË MITROVICË <https://femart-ks.com/sq/festivali-femart-ne-mitrovice/>

VAJZAT DO TË JENË VAJZA <https://femart-ks.com/sq/vajzat-do-te-jene-vajza/>

A I KEMI KALLË TUTAT TONA? <https://femart-ks.com/sq/a-i-kemi-kalle-tutat-tona/>

Nga Ivana Bilić dhe Romain Taunais

“GRATË E SOTIT, GRATË E DJESHME, BETEJA ENDE VAZHDON!”
<https://femart-ks.com/sq/grate-e-sotit-grate-e-djeshme-beteja-ende-vazhdon/>

NJË DITË PLOT ME TREGIME <https://femart-ks.com/sq/nje-dite-plote-me-tregime/>

NJË GRUA, TË GJITHA GRATË, E GJITHË SHOQËRIA
<https://femart-ks.com/sq/nje-grua-te-gjitha-grate-e-gjithe-shoqeria/>

Nga Mimoza Musliu

VETËDIJËSIM E MOTIVIM PËR VAJZA DHE GRA ME “KALLË TUTËN”, ME LARGU FRIKËN, ME JETU LIRINË
<https://femart-ks.com/sq/awareness-and-motivation-for-girls-and-women-through-burn-your-fear-to-be-fearless-and-live-the-freedom/>

GRUAJA MBËSHTET E BESON NË GRUA <https://femart-ks.com/sq/gruaja-mbeshtet-e-beson-ne-grua/>

RROTAT E KARROCËS DREJTUESE TË JETËS <https://femart-ks.com/sq/rrotat-e-karroces-drejtuese-te-jetes/>

Nga Shqipe Malushi

REFLEKSIONE
<https://femart-ks.com/sq/refleksione/>

Nga Johanna Mertinz

NJË NGJARJE PËR KOSOVËN, FESTIVALI FEMART DHE FEMINIZMI PËR TË “KALLUR TUTËN”
<https://femart-ks.com/sq/nje-ngjarje-per-kosoven-festivali-femart-dhe-feminizmi-per-te-kallur-tuten/>

VLERËSIMI DHE MONITORIMI

Vlerësimi dhe Monitorimi i aktiviteteve është bërë përmes prezencës së mediave, pyetësorëve, numrit të pjesëmarrësve dhe ndjekësve, formularëve të vlerësimit dhe intervistave.

SFIDAT DHE MËSIMET E NXJERRA

Organizimi i aktiviteteve të Artpolis dhe Festivalit FemArt ka sjellë një sërë sfidash dhe mësimesh të vlefshme. Më poshtë e gjeni një përmbledhje të sfidave kryesore me të cilat u përballëm dhe mësimet e nxjerra:

Mungesa e hapësirave të përshtatshme dhe infrastruktura e kufizuar kulturore: Një sfidë e rëndësishme ishte mungesa e objekteve të përshtatshme dhe infrastruktura e kufizuar kulturore në Prishtinë. Kjo krijoi vështirësi në gjetjen e hapësirave të përshtatshme, pasi që kishin mungesë pajisjesh që duheshin për shfaqje, ekspozita apo punëtori. Mësimi i nxjerrë është nevoja urgjente që Artpolis të avokojë fuqishëm me Komunën e Prishtinës. Organizata duhet të kërkojë një hapësirë publike në të cilën mund të investojë në renovim, duke e shndërruar atë në një qendër për art dhe komunitet. Kjo qendër jo vetëm që do të përfiton nga festivali, por edhe do t'i shërbente komunitetit si një vend për aktivitete të ndryshme gjatë gjithë vitit. Nëse bashkëpunojmë me komunën dhe sigurojmë këtë hapësirë të dedikuar, Artpolis mund të krijojë një qendër kulturore të qëndrueshme që mbështet organizatën, festivalin dhe komunitetin. Derisa të arrihet kjo, Artpolis do të ketë parasysh rëndësinë e planifikimit proaktiv dhe eksplorimit të vendeve alternative ose bashkëpunimit me institucionet ekzistuese kulturore për të kapërcyer këto kufizime.

Vonesat në përgjigjet dhe transferet e fondeve: Një sfidë tjetër ishin vonesat në marrjen e përgjigjeve ndaj aplikimeve për financim dhe në transfertat e fondeve nga donatorët. Këto vonesa dëmtuan buxhetin dhe menaxhimin financiar të festivalit. Mësimi i nxjerrë është parashikimi i vonesave të mundshme, dhe të përcaktohet kohë e mjaftueshme në përpjekjet për mbledhjen e fondeve, të ruhet komunikimi transparent me donatorët dhe të punohet fuqishëm në thjeshtimin e procedurave të transferimit të fondeve.

Kriza ekonomike dhe rritja e çmimeve: Festivali përkoi me një krizë ekonomike, ku çmimet për shërbime u rritën për shkak të inflacionit në shkallë globale. Kjo shtoi sfida në menaxhimin e shpenzimeve, tërheqjen e sponsorëve dhe ofrimin e komoditetit për pjesëmarrësit. Mësimi i nxjerrë është përshtatja me luhatjet e mundshme ekonomike, hulumtimi për masën e uljes së kostove, duke kërkuar partneritet me bizneset lokale dhe duke zbatuar opsione fleksibël të çmimeve për të siguruar qasje në qëndrueshmërinë financiare.

Përplasjet në afate kohore me ngjarje të tjera: Sfidë tjetër ishte konflikti i përputhjes kohore me organizimin e ngjarjeve të tjera që ndodhin në Prishtinë, që shkaktoi ndarje të audiencës dhe ndikoi potencialisht në pjesëmarrjen e publikut në Festivalin FemArt. Mësimi i nxjerrë është rëndësia e kryerjes së një kërkimi të plotë mbi kalendarin kulturor lokal, koordinimi me organizatorët e ngjarjeve dhe nxitja e bashkëpunimit për të shmangur mbivendosjen e datave, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e audiencës.

Mentaliteti Patriarkal: Stafi i Artpolisit mjaft shpesh ndeshet me mentalitetin patriarkal gjatë veprimit në terren, veçanërisht është problematike kur ky mentalitet është i shtrirë edhe tek përfaqësuesi e institucioneve. Dy raste që vlen të theksohen janë gjatë punës me Klubet Teatrorë në Drenas dhe Klinë. Në Drenas drejtori i gjimnazit kishte ndaluar nxënësit e shkollës për ta përcjellur shfaqjen e të rinjve të Drenasit dhe kjo është zgjidhur vetëm falë ndërhyrjes direkte nga Drejtoria e Kulturës në këtë qytet. Kurse në Klinë drejtori i Gjimnazit nuk ka lejuar stafin e Artpolis që të informojë direkt nxënësit për Klubin Teatror në Klinë, duke e quajtur madje se “arti është humbje koohe”. Por, angazhimi i Drejtorisë së Kulturës ka bërë që Klubi të themelohet me sukses.

STATISTIKAT E VITIT 2023

SHFAQJET PROFESIONALE

Aktivitete:
136

Artiste/ë dhe aktiviste/ë:
473

Pjesëmarrës:
662

Persona në audiencë:
6512

Shfaqje Teatrorë:
6

Premiera:
3

Prezantime Në Total:
17

Artiste/Ë Teatri Dhe Staf Teknik:
75

Persona Në Audiencë:
1467

EDICIONI I 11-të I FESTIVALIT FEMART

Aktivitete të organizuara:
28

Artiste/ë/aktiviste/ë/staf teknik:
304

Shtete pjesëmarrëse:
16

Vullnetare/ë në prishtinë dhe mitrovicë:
18

Persona në audiencë:
2064

Persona të arritur online:
332,763

Artikuj të publikuar në media:
50+

Blogje të publikuara:
12

AKTIVIZMI FEMINIST NË NDËRTIMIN E PAQES

Aktivitete:
15

Artiste/ë/Aktiviste/ë:
197

110 shqiptare/ë, **82** serbe/ë

Persona në audiencë:
420

KLUBET TEATRORE DHE SHFAQJET FORUM TEATËR

Klube Teatrore:

5

2 me Persona Me Aftësi Të Kufizuar

Shfaqje Forum Teatër Premierë:

6

Prezantime të shfaqjeve:

11

Pjesëmarrës në klube dhe shfaqje :

98

Persona Në Audiencë:

1333

FONDI PËR ART FEMINIST

Vepra artistike të përkrahura:

10

Artiste/ë përfitues të fondit:

29

Prezantime të veprave:

13

Persona në audiencë:

620

TRAJNIMET DHE PUNËTORITË

Trajnime

“Edukimi i grave të reja mbi feminizmin”:

10

Trajnime “Edukimi i bazuar në teatër”:

2

Trajnime të kursit të vetëmbrojtjes

“Çikat e sjellshme”:

4

Pjesëmarrës/e në trajnime:

275

Trajnerë/ligjërues:

7

Punëtori:

10

Pjesëmarrës/e në punëtori:

152

Ligjërues/e në punëtori:

37

Sesione informuese në up

“Rregullorja kundër ngacmimeve seksuale” :

10

Pjesëmarrës/e në sesionet informuese :

311

STATISTIKAT E MEDIAVE SOCIALE

ARTPOLIS // 1 Janar – 31 Dhjetor, 2023

 **732.6000** **1.513.025**
persona të arritur reagime

 **96.600** **14.885**
persona të arritura vizita

 **2.333** **5.236**
reagime vizita në profil

 Audiencia: **11.915** pëlqime // Gra **68.1%** // Burra **31.9%**

 Audiencia: **+538** ndjekës // Gra **70.7%** // Burra **29.3%**

FESTIVALI FEMART // 1 Prill – 31 Maj, 2023

 **249.932** **680,089**
persona të arritura reagime

 **75.618** **7.054**
persona të arritura vizita

 **4.300**
reagime

 **2.913**
shikime

 Audiencia: **680.089** vizita // Gra **75.5%** // Burra **24.5%**

 Audiencia: **7.054** ndjekës // Gra **73.2%** // Burra **26.8%**

MONITORIMI I MEDIAVE

Gjatë vitit 2023 aktivitetet e Artpolis kanë pasur mbulueshmëri të gjerë nga mediat lokale dhe nacionale. Rreth **250 artikuj** janë publikuar nga media të ndryshme dhe më poshtë mund të lexoni disa prej tyre:

KOHA

“Tre 1 t’eti” në kërkim të barazisë përballë zakoneve shqiptare

<https://www.koha.net/kulture/404098/tre-1-te-ti-ne-kerkim-te-barazise-perballe-zakoneve-shqiptare/>

“Pa limit” nxjerr në pah talentin e përditshmerinë e personave me aftësi të kufizuara

<https://www.koha.net/kulture/384072/pa-limit-nxjerr-ne-pah-talentin-e-perditshmerine-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/>

“FemArt” në tejkallim të frikës i jep zë guximit

<https://www.koha.net/kulture/377895/femart-ne-tejkallim-te-frikes-i-jep-ze-guximit/>

“Fefu dhe shoqet e saj” përballë realitetit në kërkim të barazisë

<https://www.koha.net/shtojca-kulture/396401/fefu-dhe-shoqet-e-saj-perballe-realitetit-ne-kerkim-te-barazise/>

KultPlus

“Gratë Trojane – Replika”, eksplorimi kohor i dhimbjes me thirrjen për paqe

<https://www.kultplus.com/lajme/grate-trojane-replika-eksplorimi-kohor-i-dhimbjes-me-thirrjen-per-paqe/>

Zjarri i teatrit, filozofisë dhe muzikës mbyll “Kalle Tutën” përmes Femart

<https://www.kultplus.com/lajme/zjarri-i-teatrit-filozofise-dhe-muzikes-mbyll-kalle-tuten-permes-femart/>

Kallxo

‘Shkolla Pranverore Feministe’ bën bashkë në Prizren gra e vajza nga Kosova e Serbia

<https://kallxo.com/lajm/shkolla-pranverore-feministe-ben-bashke-ne-prizren-gra-e-vajza-nga-kosova-e-serbia/>

Shfaqja serbe në Kosovë i bashkon dy vendet në luftën e tyre kundër patriarkatit

<https://kallxo.com/lajm/shfaqja-serbe-ne-kosove-i-bashkon-dy-vendet-ne-luften-e-tyre-kunder-patriarkatit/>

“Poezi dhe Fuqi”, iniciativa artistike që mbledhi fonde për tri gra të prekura nga vërshimet

<https://kallxo.com/lajm/poezi-dhe-fuqi-iniciativa-artistike-qe-mbledhi-fonde-per-tre-gra-te-prekura-nga-vershimet/>

Telegrafi

Artpolis me marsh dhe performancë artistike në Prishtinë kundër femicidit: Kriminelët të dënohen maksimalisht

<https://telegrafi.com/artpolis-marsh-dhe-performance-artistike-ne-prishtine-kunder-femicidit-kriminelet-te-denohen-maksimalisht/>

Klan Kosova

Rama: Prishtina është shtëpia e një skene të larmishme dhe të gjallë feministe

<https://klankosova.tv/rama-prishtina-eshte-shtepia-e-nje-skene-te-larmishme-dhe-te-gjalle-feministe/>

Mbahet marshi kundër vrasjes së grave me moton “Stop femicidit”

<https://klankosova.tv/mbahet-marshi-kunder-vrasjes-se-grave-me-moton-stop-femicidit/>

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE



TË ARDHURAT

TË ARDHURAT € 591,610

TOTALI I TË ARDHURAVE € 591,610



SHPENZIMET

SHPENZIMET E PAGAVE E STAFIT / PERSONATE JASHTËM € 297,467

SHPENZIMET OPERATIVE € 289,377

SHPENZIMET E ZHVLERËSIMIT € 4,766



TOTALI I SHPENZIMEVE € 591,610

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NGA DONATORËT

	TË ARDHURAT	SHPENZIMET
KTK	€ 40,433	€ 40,433
UNFPA	€ 29,214	€ 29,214
UNFPA 2	€ 39,765	€ 39,765
CDF	€ 53,530	€ 53,530
CFD	€ 80,627	€ 80,627
KCSF	€ 43,894	€ 43,894
MINISTRIA E KULTURËS	€ 80,000	€ 80,000
KOMUNA E PRISHTINËS	€ 10,000	€ 10,000
EU	€ 60,146	€ 60,146
AMBASADA AMERIKANE	€ 11,673	€ 11,673
KBFUS	€ 34,366	€ 34,366
AMBASADA FRANCEZE	€ 7,057	€ 7,057
BUÇAJ	€ 4,479	€ 4,479
TË HYRA NGA ANËTARSIA	€ 126	€ -
TË HYRA NGA SPONZORIMI	€ 89,825	€ 89,825
TË HYRAT E SHTYRA NGA VITI PARAPRAK	€ 107,812	€ 6,601
TË HYRAT E SHTYRA TË VITIT AKTUAL	€ (101,337)	
TË ARDHURAT TOTALE NGA DONATRËT	€ 560,510	€ 560,510

Pasqyrat financiare janë përgatitur për qëllime raportimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në fuqi dhe ato përfaqësojnë të gjithë pasqyrën që ka ndodhur në Artpolis gjatë vitit 2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parave të gatshme, sipas së cilës të ardhurat dhe shpenzimet njihen në kohën kur merren ose paguhen. Organizata përdor Quick Books për të përgatitur pasqyrat financiare.

Më poshtë mund të gjeni linkun e Raportit të Auditimit të Artpolis për vitin 2023:
<https://artpolis-ks.com/raporti-i-auditit-2022/>

STAFI I QENDRËS PËR ART DHE KOMUNITET - ARTPOLIS, 2023



Foto: Esad Duraki

Zana Hoxha, Themeluese dhe Drejtore Ekzekutive

Donarta Limanaj, Menaxhere e Financave dhe Administratës

Nertila Qarri-Gërguri, Menaxhere e Projekteve

Venera Ismaili, Menaxhere e Projekteve

Mërgim Memoviq, Menaxher i Projekteve

Berat Bajrami, Koordinator i Projekteve dhe zyrtar për PR

Elira Lluka, Zyrtare për PR

Valëza Sijarina, Koordinatore e Projekteve

Arbnora Kajtazi, Asistente e Financave

Mimozë Musliu, Asistente e Projekteve

Rukije Gashi, Mirëmbajtëse e Zyrës

Manon Pilia, Praktikante

ANSAMBLI I ARTPOLIS 2023



Foto: Rilind Beqa

Regjisore: Zana Hoxha

Koreograf: Robert Nuha

Dramaturg/aktor: Shpëtim Selmani

Aktoret/ët: Blerta Gubetini, Donikë Ahmeti, Edlir Gashi, Kaltrinë Zeneli, Mikel Markaj, Labinot Raci, Qendresa Kajtazi, Zhaneta Xhemajli

Organizatore: Elira Lluka

BORDI I ARTPOLIS 2023



Aurita Agushi

Jelena Memet

Kushtrim Qerimi

Dardan Kryeziu

DONATORËT E ARTPOLIS



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT



cfd
Die feministische
Friedensorganisation



CDF
Center for Dialogue and Facilitation



KVINNA
KVINNA



Funded by
the European Union



KCSF



UNFPA



AMBASSADE
DE FRANCE
AU KOSOVO
Liberté
Égalité
Fraternité



UNITED STATES OF AMERICA
PRISHTINA



PRISHTINA



BUÇAJ



KING BAUDOUIN
FOUNDATION
UNITED STATES

RRJETET SOCIALE TË ARTPOLIS DHE FESTIVALIT FEMART

ARTPOLIS



Artpolis - Art and Community / <https://www.facebook.com/artpolisKosovo>



ArtpolisCenter / <https://www.instagram.com/artpoliscenter/>



QendraArtpolis / <https://twitter.com/qendraartpolis?lang=en>



Artpolis - Art and Community / <https://vimeo.com/artpoliscenter>



<https://artpolis-ks.com/>

FEMART



FemArt Kosova / <https://www.facebook.com/FemartKosova>



FemArtKosovo / <https://www.instagram.com/femartkosovo/>



FemArtKosovo / <https://twitter.com/FemArtKosovo>



FemArt Festival / <https://femart-ks.com/>



FemArt Festival / <https://bit.ly/3KoTtck>

